





KËSHILLA

Përmbajtja/ Dhjetor 2009 (Nr. 37)

Do të lexoni:

■		Drejtësia	8
■		Kuptimi i karakterit të njeriut	12
■		Një ravijëzim i femrës shqiptare në kohëra	18
■		Kiameti	30
■		Rrëfimet e Kur'anit famëlartë dhe qëllimet e këtyre rrëfimeve	34

e të tjera...

KËSHILLA

Nr. 37, Dhjetor, 2009
Organ i Fondacionit të Kur'anit

Drejtore:
Prof. Muhammed Reza
HAXH KHEZR

Kryeredaktore:
Liseda RAMAJ

Drejtore artistike:
Vullnet MERJA

Korrektore:
Vjollca FEZA

Design & Layout:
Aurora SHEHU

Bashkëpunuan:
Vullnet MERJA,
Vjollca FEZA,
Sabrie FEZA,
Selim STAFJA,
Majlinda NDRECA,
Jetmir ÇELA etj.

Adresa: Rr. Hoxha Tahsim Nr. 168
Kutia Postare: 8272
Tel & Fax: 00355 04-2 377 311
Tirana – Albania
WebSite: www.fqurani.com
E-mail: f_quran114@yahoo.com



Me emrin e All'Ilahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Njeriu, krijesa më e përsosur e All'Ilahut të Madhëruar është gjithnjë kaq i vogël..., pavarësisht nga pozita e tij në këtë botë. Një ndër hapësirat ku ai e ndjen veten të realizuar është pikërisht gjatë ritualit të Haxhit. Vlerat që fiton ai gjatë Haxhit do ta ndjekin gjatë gjithë jetës, e gjithashtu, ai ka siguruar përfitime për Botën Tjetër. Me anë të devotshmërisë dhe të nënshtrimit të plotë ndaj All'Ilahut, besimtarët kërkojnë të arrijnë fitimin e kënaqësisë së Tij. "Pastaj, haxhinjtë le të pastrojnë trupin e tyre, le t'i kryejnë zotimet e tyre dhe le të rrotullohen rreth Shtëpisë së lashtë."

(El Haxh, ajeti 29)

Duke shprehur që adhurimet e besimtarëve gjatë Haxhit të jenë të pranuar, ne u urojmë atyre mirëseardhjen me përmallim.

Kryeredaktorja



HAXHI,

All'Ilahu i Madhëruar në Kur'an thotë: "Shtëpia (xhamia) e parë e ndërtuar për njerëz, është ajo që u ngrit në Bekë (Meke), e dobishme e udhërrëfuese për mbarë njerëzimin.

Aty ka shenja të qarta: vendi i Ibrahimit dhe kush hyn në të, ai është i sigurt. Për hir të All'Ilahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është detyrim për atë që ka mundësi udhëtimi tek ajo, e kush nuk e beson (ai nuk e viziton); All'Ilahu nuk është i nevojshëm për (ibadetin që e bëjnë) njerëzit". (Sure "Ali Imran", ajetet 96-97).


Nuk është çudi që Qabja të jetë kibleja e myslimanëve, sepse ajo është vendi i parë i teuhidit dhe

vendadhurimi më i hershëm në sipërfaqen e tokës për adhurimin e All'Ilahut të Madhëruar. Ajo është shtëpia e parë e ndërtuar për të gjithë njerëzit, edhe pse u ndërtua në një vend të thatë, por ai vend është i mbushur plot me mirësi. Tekstet islame dhe ato historike na sqarojnë se Qaben e ndërtoi Hz. Ademi (paqja qoftë mbi të!), pastaj u shemb për shkak të tufanit që ndodhi në kohën e Hz.

Nuhit (paqja qoftë mbi të!) dhe më vonë u rindërtua nga Hz. Ibrahim (paqja qoftë mbi të!). Nuk ka asnjë dyshim se zgjedhja e shtëpisë më të hershme, e cila u themelua për teuhidin me qëllim që të jetë Kibleja e myslimanëve, është më e përsosur se sa zgjedhja e një vendi tjetër. Dhe për këtë, All'Ilahu i Madhëruar në Kur'an thotë: "Përkujtoje kur ne e udhëzuam Ibrahimin për në vendin e shtëpisë (Qabes): të mos më përshkruajë Mua shok, pastroje shtëpinë Time për ata që e vizitojnë (bëjnë tavaf), që qëndrojnë në këmbë duke u falur, përkulur dhe që bëjnë sexhde." (Sure "Haxh", ajeti 26). Siç e shohim, në këtë ajet kur'anor Qabja quhet edhe "Bejtullah" (shtëpia e All'Ilahut).


Ndërsa, ajeti i lartpërmendur e cilëson Qaben si shtëpinë e njerëzve. Kjo thënie zbulon një të vërtetë: "Çdo gjë që është e lidhur me All'Ilahun e Madhëruar, ajo është e Tij dhe është detyrim që kjo të jetë në shërbim të njerëzve, dhe çdo gjë që është në shërbim të njerëzve të devotshëm, ajo është për All'Ilahun e Madhëruar".

Haxhi, ashtu si dhe në ibadetet e tjera përmban mirësi të shumta për individët dhe shoqërinë. Nëse zbatohen ashtu siç duhet, këto ibadete sjellin ndryshime të mëdha tek individët dhe shoqëritë islame. All'Ilahu i Madhëruar në Kur'an thotë: "(vijne) Për të qenë të pranishëm në dobitë e tyre dhe që ta përmendin All'Ilahun në ato ditë të caktuara (në shenjë falënderimi) dhe për atë që i ka furnizuar me kafshë. Hani pra, prej tyre (kurbanëve) dhe ushqeni të ngushtuarin dhe të varfërin". (Sure "Haxh", ajeti 28). Në këtë ajet kuptojmë se njerëzit të Haxhi gjejnë dobi të mëdha dhe njëkohësisht, ata afrohen më tepër me Krijuesin e tyre duke iu përmbajtur ligjeve të fesë islame. Gjithashtu, Haxhi dallohet me disa dobi të rëndësishme siç janë: përfitimi moral, kulturor, ekonomik etj.



1- Përfitimi moral:

Ana më e rëndësishme e filozofisë së Haxhit është ajo morale, sepse gjatë kësaj periudhe ana morale e njerëzve arrin të bëhet më e përsosur. Veprimet e Haxhit e largojnë plotësisht njeriun nga çështjet materiale dhe kjo fillon që në pamjen e jashtme sepse në Haxh nuk vishen rroba luksoze, gjithashtu, e largojnë nga epshet e papëlqyera dhe si rezultat ai person hyn në botën e dritës dhe të lartësimit shpirtëror. Më pas, janë veprimet që kryhen mbas veshjes së ihramit të cilat shfaqin marrëdhëniet shpirtërore të njeriut me Krijuesin e tij, duke e harruar të shkuarën e tij të mbushur me gjynahe dhe duke u bashkuar me një të ardhme të mbushur me dritë dhe harmoni. Çdo hap që bën personi në Haxh, ai ndjen praninë e Hz. Ibrahimit (paqja qoftë mbi të!), thyesit të statujave, kujton Ismailin (paqja qoftë mbi të!) dhe nënën e tij, Haxhiren. Shikon Qaben dhe vendin e Tavafit rreth saj. Haxhi i kujton Profetin Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!),



udhëheqësit

të devotshëm të

Islamit, si dhe xhihadin e myslimanëve në fillim të Islamit. Këto ndjenja bëhen më të forta kur ai person që ka shkuar në Haxh arrin të shohë çdo anë të Mesxhidit Haram dhe të tokës së bekuar të Qabes dhe të gjitha ndodhitë dhe ngjarjet islame. Ai arrin të dëgjojë zërin e shpatave të myslimanëve, si dhe, zërat e kuajve të tyre. Të gjitha këto bashkohen në zemrat e tyre deri në atë mënyrë sa që i hap një horizont të ri jetës individuale. Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Haxhi është lindje e dytë për myslimanin. Pas kryerjes së Haxhit për myslimanin lind një jetë e re. Por, për ata persona të cilët marrin prej Haxhit lëvozhgën dhe hedhin në një anë bërthamën, apo e konsiderojnë atë udhëtim turistik, ose për t'u dukur dhe për t'u krenuar etj., këta persona nuk e kanë arritur vërtetësinë e Haxhit dhe do të marrin si shpërblim atë që meritojnë.

2- Përfitimi kulturor

Takimi i myslimanëve në ditën e Haxhit luan një rol të madh në shkëmbimet e kulturave në shoqëritë islame. Kjo ndodh sepse në sezonin e Haxhit marrin pjesë myslimanë nga të gjitha vendet e botës. Edhe pse kombet dhe gjuhët e tyre ndryshojnë, ata kanë një qëllim të përbashkët. Në thëniet islame gjejmë se dobia e Haxhit është përhapja e gjurmëve të Profetit (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) në të gjithë botën islame. Po ashtu, Haxhi është edhe konferenca e kulturës islame, sepse në të marrin pjesë mendimtarë dhe dijetarë të Islamit, të cilët shfaqin dhe diskutojnë pikëpamjet e tyre me njëri-tjetrin. Vërtet, kufijtë në mes vendeve islame janë shkaktarë të shpërbërjes së kulturës origjinale të tyre dhe se çdo mysliman mendon vetëm për vendin e tij. Kjo çoi deri në ndarjen e shoqërisë së përbashkët islame. Por, Haxhi është në gjendje ta ndryshojë këtë situatë. Sa e bukur është thënia e transmetuar nga Hisham Ibnul Hakem nga Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) në të cilën thuhet: "Nëse çdo komb do të fliste vetëm për vendin e tij, ata do të mbaronin, vendet e tyre do të shkatërroheshin, fitimet do të pakësoheshin dhe lajmet do të humbisnin".

3- Përfitimi ekonomik:

Në ndryshim të pikëpamjes që kanë disa, gjatë Haxhit mund të përfitohet edhe në forcimin e bazave të ekonomisë në vendet islame, por, në bazë të thënieve të sakta islame duket qartë se dobia ekonomike është një pjesë e rëndësishme e filozofisë së Haxhit. Në Kur'an thuhet: "Nuk është

gjynah për ju të kërkonti begati nga Zoti juaj.” (të bëni ndonjë tregti gjatë Haxhit). (Sure “El-Bekare”, ajeti 198). Haxhi është detyrim për t’u kryer nga të gjithë ata persona, të cilët kanë mundësi ekonomike dhe shëndetësore. Me kryerjen e Haxhit, ne jo vetëm që zbatojmë urdhrin e All’llahut, por, na është dhënë mundësia që edhe të përfitojmë prej tij ashtu siç e thamë më lart në ajetin e Kur’anit. Atëherë, këtu shtrohet pyetja: Ku është pengesa që të ngrihet një treg i përbashkët islam gjatë kohës së Haxhit, me qëllim që myslimanëve t’u hapen mundësitë për tregti në mes tyre dhe fitimet të kthehen tek ata dhe jo tek armiqtë e tyre? Me pak fjalë themi se, Haxhi është një adhurim i madh nëse përfitohet prej tij për zhvillimin e seminareve të shumta kulturore, ekonomike, politike dhe morale, me qëllim që të zgjidhë të gjitha problemet e botës islame. Në një hadith të Imam Sadikut thuhet: “Feja qëndron deri sa të jetë Qabja.”

Haxhi përmban në vetvete ndikime dhe mirësi të shumta. Ai është burimi i madhështisë së Islamit dhe i unitetit të myslimanëve për t’u përballur me çdo furtunë të armiqve të tyre, sepse këta të fundit e kuptuan më së miri rëndësinë e Haxhit, rreth të cilit njëri prej dijetarëve të tyre thotë: “Ne nuk mund të arrijmë të triumfojmë mbi myslimanët përderisa Haxhi ndodhet në mesin e tyre”. Po një tjetër dijetar thotë: “Mjerë myslimanët nëse nuk e kuptojnë Haxhin dhe mjerë armiqtë nëse e kuptojnë atë”. Me pak fjalë, mund të themi se Haxhi vërtet është një burim që të çon drejt shumë gjërave pozitive si nga ana shpirtërore, ashtu dhe nga ana morale e shumë e shumë të tjera. Stafi i Fondacionit të Kur’anit u uron të gjithë haxhinjve rrugëtim të mbarë dhe All’llahu ua pranoftë Haxhin në atë vend të bekuar, inshaAll’llah!

Për ju të dashur lexues po paraqesim disa fragmente të shkëputura nga duaja e Arafatit e cila këshillohet të lexohet jo

vetëm në ditën e Arafatit, por edhe në ditët e tjera; kjo për shkak të përmbajtjes së kësaj lutjeje të përkryer:

“O Zoti im, unë jam ai që i pranoj gjynahet e mia, prandaj m’i fal ato, unë jam ai që kam vepruar keq, unë jam ai që kam gabuar, kurse Ti përsëri më fal. O Zoti im, unë jam ai që edhe pse s’e bëja të keqen, synoja ta bëja atë. Unë jam ai i padituri, unë jam ai i pavëmendshmi, unë jam ai që harroja, unë jam ai që veproja me qëllim, unë jam ai që premtoja dhe i thyeja ose s’i mbaja premtimet, unë jam ai që pohova dhe pranova mirësitë e Tua e unë jam ai që i pranova gjynahet e mia. O Zot, të kërkoj falje për të gjitha këto.

O Zot, Ty nuk të dëmtojnë gjynahet e robëve dhe Ti s’ke nevojë për adhurimet e tyre.

O Zot, Ti je Ai që mbarëson dhe shëron ata që bëjnë vepra të mira. Ty të falënderoj, o i Zoti im, o Kujdestari im....

“O Zot, ne të drejtohem i Ty në këtë natë të cilën e ke nderuar dhe e ke lartësuar, për hir të Muhammedit, të Dërguarit Tënd, më të përsosurit të krijesave të Tua, besnikut të shpalljes Tënde, të cilin e dërgove përgëzues, qortues, pishtar ndriçues, me të cilin i ke bekuar myslimanët dhe e ke dërguar mëshirë për të gjitha krijesat.

“O Zot, na cakto në këtë natë pjesë prej çdo mirësie të cilat Ti i ndan për robtë e Tu.

O Zot, na jep dritë me të cilën Ti udhëzon.

O Zot, na jep prej begative që Ti i zbret.

O Zot, na jep prej shëndetit që Ti e përhap.

O Zot, na jep prej begative që Ti dhuron.

O Mëshirues, o Mëshirëbërës....”

“O Zot, na ndihmo në kryerjen e Haxhit tonë, na e plotëso atë, na fal neve dhe na jep shëndet.

O Zot, duart i kemi ngritur nga Ti dhe ato pohojnë për Ty.

O Zot, na jep në këtë natë të gjitha ato që të kërkuam...”

DREJTËSIA

Drejtësia është prej bazave morale në Islam. Drejtësia në marrëdhëniet shoqërore do të thotë: e vërteta dhe drejtësia të jenë prezente gjithmonë tek ne; pra, të themi të vërtetën dhe ta zbatojmë atë edhe nëse është kundër nesh, të duam për të tjerët atë që duam për veten tonë. Drejtësia është shkak i ekzistencës së bazave konstante (të palëkundshme) në jetën shoqërore që ligjet e saj të zënë vend tek të gjithë. Pra, drejtësi do të thotë: zbatim i ligjit. Vërtet, të drejtat e individëve dhe detyrat e tyre janë të përcaktuara në atë mënyrë që të vërtetohet drejtësia. Gabimi në këtë do të thotë shprehje e padrejtësi. Puna është se njerëzit flasin shumë për drejtësinë. Por, kur kjo drejtësi është në dobi të tyre individuale, ata zgjedhin interesin e tyre. dikush e ndërron një ligj që të përfitojë për vete.



Imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Drejtësia është gjëja më e gjerë në njohje dhe më e ngushta në veprim.” (“Nehxhul Belaga”; f. 332, fjalimi 216)

Kur flasim për drejtësinë, fluturojmë në qiellin e të menduarit. Por, kur e drejta na bëhet detyrë për t’u zbatuar tek të tjerët, ne biem në hall të madh! Drejtësia është

me fjalë dhe me vepër.

All’llahu i Madhëruar thotë: “...Kur të flisni (të dëshmoni), duhet të jeni të drejtë edhe nëse çështja është për (kundër) të afërmit. Dhe zotimin e dhënë All’llahut plotësojeni. Këto janë ato që Ai ju porosit, kështu që të kujtoni.” (Sure “El-En’am”, 152).

Dhe: “O ju që besuat, të jeni gjithnjë

dëshmuës të drejtë për hir të All'Ilahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes tuaj, kundër prindërve, ose kundër të afërmeve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose i varfër, sepse All'Ilahu di më mirë për ta. Mos ndiqni, pra, emocionin e t'i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrembëroni ose tërhigjeni, All'Ilahu e di hollësisht çfarë bëni." (Sure En Nisa, 135).

Sipas këtij ajeti duket qëndrimi i njeriut besimtar i cili ka si bazë drejtësinë dhe të vërtetën.

Pra, ka një peshore të përhershme dhe kjo peshore është drejtësia. Kjo peshore nuk u nënshtrohet ndikimeve të jashtme, p.sh. nuk ndikohet prej marrëdhënieve, emocioneve e lakmisë. Kjo do të thotë se njeriu duhet të gjykojë me drejtësi në çdo vend e në çdo kohë, qoftë ky gjykim kundër vëllait të vet, nënës së vet, babait të vet. Njeriu duhet të gjykojë me drejtësi edhe nëse i akuzuari është i varfër dhe të mos i japë të drejtë të pasurit për shkak të pasurisë që ka.

All'Ilahu i Madhëruar thotë: "O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të All'Ilahut, duke dëshmuar të drejtën dhe të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë! Bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kijeni frikë All'Ilahun, se All'Ilahu e di hollësisht se çfarë bëni." (Sure " El Maide", 8).

Peshorja e drejtësisë nuk ndikohet prej marrëdhënieve tona me të tjerët. Mundet që dikush të bëjë ndonjë vepër të keqe; por ne duhet të jemi të drejtë me të duke zbatuar drejtësinë.

Hadithet e përcjella nga Profeti e lavdërojnë

Këtu po përmendim disa fjalë përmbledhëse të imam Aliut (paqja qoftë mbi të!) rreth drejtësisë:

1- "Drejtësia është shkak i vazhdimësisë së dashurisë." ("Gurerul Hikem", f. 393)

2- "Drejtësia bashkon zemrat." ("Gurerul Hikem", f. 393)

3- "Drejtësia largon kundërshtimet dhe sjell dashuri." ("Gurerul Hikem", f. 393)



shumë vlerën e drejtësisë.

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Njeriu më i drejtë është ai që do për njerëzit atë që do për veten e tij dhe urren për ata atë që urren për veten e tij." ("Biharul Enuar", vëll. 75, kreu 35, hadithi 1)

Imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "All'Ilahu do ta bëjë krenar atë që bën drejtësi me njerëzit." ("Biharul Enuar", vëll. 75, kreu 35, hadithi 25)

Në testamentin e tij për imam Hasanin (paqja qoftë mbi të!) imam Aliu thotë: "O biri im, barazojë veten tënde me të tjerët. Dëshiro për të tjerët atë që dëshiron për veten tënde dhe urre për të tjerët atë që urren për veten tënde! Mos bëj padrejtësi, sillu mirë si dëshiron që të sillen mirë me ty. Përbuz për veten tënde atë që e përbuz për të tjerët, duaj për

njerëzit atë që do për veten tënde dhe mos thuaj për ta atë që nuk të pëlqen të ta thonë ty.” (“Biharul Enuar”, vëll. 75, kreu 35, hadithi 21)

Në këtë tekst testamenti shohim një program të hollësishëm për drejtësinë. Ky program është që vetë njeriu të jetë peshore. T’i duam tjetrit atë që e duam për veten tonë dhe të urrejmë për të atë që e urrejmë për veten tonë, të mos i bëjmë padrejtësi askujt, siç nuk duam që të na bëjnë padrejtësi.

Imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) i ka thënë Malik Eshterit: “Bëhu i drejtë ndaj All’llahut dhe ndaj njerëzve, ndaj vetes tënde, veçanërisht me familjen tënde dhe me ata që janë nën përgjegjësinë tënde. Nëse nuk vepron kështu, do të jesh i padrejtë. Atij që është i padrejtë, All’llahu do t’i jetë kundërshtar. Për atë që All’llahu është kundërshtari i tij, do t’i dobësohen faktet dhe do të jetë në luftë me Zotin derisa të bindet e të pendohet (për padrejtësitë e bëra).” (“Biharul Enuar”, vëll. 33, kreu 3, hadithi 744)

Kujtesë morale

Prej haditheve të mësipërme nxjerrim si përfundim se drejtësia dhe barazia në marrëdhëniet shoqërore do të thotë barazi e vetes me të tjerët në të gjitha të drejtat shoqërore. Shoqëria islame është e ndërtuar mbi barazinë në të drejta dhe detyrime. Ajo është shoqëri e pavarur, e solidarizuar dhe sipërmarrëse për përhapjen e dashurisë, të respektit dhe të miqësisë.

Por, duhet të kuptojmë se barazia e njerëzve me vetveten është çështje e vështirë, sepse njeriu bie në kundërshtim me “dashurinë e vetvetes”, e cila i ka rrënjët në brendinë e njeriut. Për këtë, imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “A t’ju them gjënë më të lartë, të cilën All’llahu ua ka bërë detyrë (farz) krijesave të Tij? - Barazia e njerëzve me vetet e tyre.” (“Biharul Enuar”, vëll. 72, f. 27)

Në jetëshkrimin e imam Sadikut (paqja qoftë mbi të!) transmetohet se një prej shokëve të tij i ka dërguar një letër dhe e ka pyetur për disa çështje. Imami u është përgjigjur çështjeve përveç njërës, e cila kishte të bënte me të drejtat e besimtarëve. Kur erdhi koha të udhëtonte nga Medina, shkoi të takonte imamin dhe i tha: “O zotëria im, përse nuk iu përgjigje pyetjes sime?” Imam Sadiku i tha: “Kisha frikë se po të përgjigjesha nuk do ta zbatoje dhe do të dilje nga feja.” Më pas i tha: “All’llahu u ka bërë detyrim robve të Tij tri gjëra më të mëdha: barazinë e tjetrit me veten tënde, të veprosh me vëllanë tënd mysliman ashtu siç do të veprohet me ty, të këshillosh vëllezërit e tu, ta përmendësh All’llahun në çdo kohë jo vetëm duke thënë “SubhanAll’llahi, uel hamdulil-lahi”, por nëse të propozohet diçka e ndaluar (haram), ta kujtosh All’llahun.”

Pra, barazia me të tjerët është prej detyrave më të rrepta, të cilën All’llahu e ka caktuar për robtë e Tij. Për këtë, duhet që çdo mysliman të bëjë xhihad me veten e tij dhe ta qetësojë veten, që ta shohë drejtësinë në sytë e tij përherë. Ai duhet të thotë vetëm të vërtetën, të zbatojë të drejtën duke dashur për njerëzit e tjerë atë që do për veten e tij dhe t’u urojë atyre gjithmonë të mirën, ashtu siç e uron për veten e tij.

Përmbledhje

Drejtësi do të thotë barazia e tjetrit me veten në çdo të drejtë shoqërore dhe zbatimi i kësaj barazie. Me këtë veprim sigurohet krenaria, pavarësia dhe siguria në shoqëri; rritet solidariteti mes njerëzve dhe përhapet dashuria e miqësia.

Barazia, siç u pa në hadithe, është prej detyrave të vështira të caktuara nga All’llahu i Madhëruar.

Emrat e Zotit

El Muhejminu

Mbizotëruesi

"Ai është All'Ilahu që nuk ka zot tjetër përveç Tij, Sunduesi, i Shenjti, Paqedhënësi, Siguruesi, Mbizotëruesi." (Sure El Hashr, ajeti 23)

All'Ilahu është Ruajtës i madh dhe është Vigjilent mbi çdo gjë. "...nuk ka asgjë nga gjallesat, e që Ai të mos e ketë nën sundim..." (Sure Hud, ajeti 56)

All'Ilahu e kontrollon krijimin dhe e ruan atë nga prishja dhe humbja, vetëm se nga dëshira e Tij. Kur'ani ka cilësi të njëjta. "Dhe Ne të kemi dërguar ty Librin me të vërtetën që është vërtetues i Librit para tij dhe garantues i tij..." (Sure El Maide, ajeti 48)

Kjo do të thotë se Kur'ani është kriteri me të cilin i gjykojmë Librat e tjerë të shpallur.

Ai është dëshmitar se çka thonë dhe bëjnë krijesat. Asgjë s'i ikën dijes së Tij, as sekretet në zemrat e njerëzve. "E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do të gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë." (Sure Ez Zelzele, ajetet 7-8) "Ai është mbizotërues ndaj robëve të Vet. Ndaj juve dërgon rojë. (cakton melekë)." (Sure El En'am, ajeti 61)

"O Zoti im! Kërkoj mbrojtjen Tënde nga mjerimi dhe brenga, nga dobësia dhe dembelia, nga kopracia dhe frika, nga ngarkesa e borxheve dhe nga gjërat që do t'i bëjnë të tjerët të më mundin." (Buhariu e Muslimi)



karakterit

të njeriut



Dimensionet e karakterit

Tani, që u qartësua kuptimi i karakterit, do të përpiqemi të trajtojmë dimensionet e ndryshme të tij, ku te disa prej tyre do të ndalemi më hollësisht.

1- Drejtësia apo kërkimi i së vërtetës, është një nga dimensionet kryesore të karakterit, që në vetvete përbën një forcë të brendshme tërheqëse në drejtim të së vërtetës. Që në kohët e lashta, dëshira për të gjetur të vërtetën e ka shtyrë njeriun, që, pavarësisht vështirësive që haste, të përparonte në drejtim të dijes dhe të pranonte mendimet e dijetarëve të

ndryshëm, sepse një gjë e tillë e qartësonte dhe e bindte për diçka që ishte e paqartë dhe që e vërteta në lidhje me të nuk dihej.

Kjo tregon që, kur njeriu arrin të njohë të vërtetën, ndien kënaqësi, që është edhe forca motorike që e vë në lëvizje për probleme më të thella. Duhet theksuar se njerëzit, që këtë veçori e kanë më të theksuar dhe e kanë të zhvilluar në nivele më të larta, ndiejnë kënaqësi më të madhe në rastet kur gjejnë një të vërtetë. Për shembull, shkencëtarët, filozofët dhe çdokush që merret me kërkime, këtë veçori e kanë më të zhvilluar se të tjerët dhe e kanë mbajtur gjallë në brendësi të tyre duke e kultivuar me kujdes. Pjesë

të autobiografive të njerëzve të mëdhenj tregojnë për forcën e madhe tërheqëse që zotëron ky dimension i karakterit.

Kërkimi i së vërtetës të fëmija shfaqet në formën e kureshtjes, duke bërë herë pas here pyetje të ndryshme. Në qoftë se ky lloj dimension i zhvillohet në kah pozitiv, fëmija arrin kulmin e kureshtjes, që gjithmonë është në gjendje të aktivizuar dhe e shqetëson atë. Një dimension i tillë ka ekzistuar te njeriu në të gjitha kohërat, duke u klasifikuar si virtyt i lartë.

Po ashtu, njerëzit që përpiqeshin ta zhvillonin më tej këtë dimension, siç është rasti i shkencëtarëve, kanë qenë të respektuar nga masa e gjerë.

Nga ana tjetër, njerëzit që ishin pronarë të pasurive të mëdha, asnjëherë nuk e kanë arritur atë shkallë shoqërie që u mundësonte dimensionin i kërkimit të së vërtetës. Rruga për mbajtjen gjallë të këtij virtyti të shenjtë është dorëzimi dhe heqja dorë nga çdo lloj kundërshtimi dhe rezistence përballë së vërtetës. Ai njeri, që këtë virtyt e ka të zhvilluar në kahun negativ, gjithmonë shfaq rezistencë dhe dyshim në lidhje me të vërtetën dhe nuk e pranon atë.

Ai, këtë pishtar të shenjtë, e mban të fikur brenda vetes.

2- Dëshira për të bërë mirë. Kuptimin e kësaj shprehjeje do ta shpjegojmë në dy drejtime, atë personal dhe atë shoqëror. Cilësitë, si guximi për të bërë mirë, dëshira për rregullin, etj., përbëjnë drejtimin personal të dëshirës; kurse cilësitë, si: ndihma për tjetrin, sakrifica, të ardhurit keq, të bërit shoqëri, etj., përbëjnë grupin shoqëror të këtij dimension. Njeriu, sa më shumë ta ketë të zhvilluar dëshirën për të bërë mirë, aq më shumë ai ndien gëzim dhe kënaqësi pas një veprimi të tillë. Për këtë arsye,

tek persona të ndryshëm, kënaqësia dhe gëzimi janë të ndryshme.

Njerëzit, që më tepër kanë të zhvilluar instinktet trupore, ndiejnë kënaqësi vetëm në rast të plotësimit të dëshirave të tyre trupore dhe nuk mund të shikojnë dot me larg se kaq dhe nuk janë në gjendje të konceptojnë dot se çfarë është sadakaja (ndihma për njerëzit në nevojë).

3- Pëlqimi i së bukurës, është një tjetër dimension i karakterit të njeriut. Edhe kjo cilësi është vendosur në shpirtin e tij në mënyrë të tillë që ai të ndiejë kënaqësi kur përballet me diçka të bukur. Njeriu, jo vetëm kënaqet nga bukuritë e natyrës, por edhe nga bukuria e krijimit, p.sh: të bukurën nuk e gjejmë vetëm në art, po edhe te prodhimi i produkteve të ndryshme. Edhe në krijimin e njeriut kemi të bëjmë me një bukurë, ndaj së cilës njeriu nuk mund të tregohet indiferent. Kjo gjë vërteton edhe faktin se njerëzit, që në kohët e hershme i pëlqenin artet e bukura. Gjetja e figurave dhe e pikturave të shumëllojshme në shpella e vërteton këtë. Edhe Kur’ani i Madhëruar e thekson këtë





fakt, duke cituar se bukuritë e botës janë në dispozicion të njeriut falas. Bukuria ndahet në disa grupe:

a) Bukuria e ndjeshme është ajo lloj bukurie që mund të perceptohet me ndihmën e pesë shqisave njerëzore, si për shembull: piktura, muzika, etj.

b) Bukuria shpirtërore, në vetvete, ndahet në dy nëngrupe, ku nëngrupi i parë përfshin vetë kuptimin e fjalës, si për shembull: bukuria e krijesave të ndryshme, ekuilibri i saktë që është vendosur kudo, etj. Nëngrupi i dytë ka të bëjë me bukuritë e një shkalle më të lartë, që i bashkëngjiten shpirtit, siç janë: pastërtia shpirtërore, drejtësia, trimëria, durimi, etj. Njeriu, sa më i pastër të jetë nga pikëpamja shpirtërore, aq më shumë i ndien dhe i kupton këto lloj bukurish, në krahasim me bukuritë e ndjeshme. Po ashtu, ky njeri është në gjendje të dallojë me saktësi edhe të shëmtuarat, si për shembull: gënjeshtren, tradhtinë, egon, shtypjen, agresionin, të cilat i sjellin një ndjenjë të fortë urrejtjeje. Prandaj, ai asnjëherë nuk do të donte që të ndotej në të tilla cilësi të shëmtuara. Shembulli më

i mirë për bukurinë shpirtërore janë vetë ajetet kur'anore. Kur'ani i Madhëruar është ndërtuar në mënyrë të tillë, që, si nga pikëpamja kuptimore, (detyrat, të drejtat, mendimet filozofike dhe shkencore), ashtu edhe nga pikëpamja e bukurisë së fjalës, nuk mund të krahasohet me asgjë.

Për këtë arsye Kur'ani gjen vend menjëherë në zemrat e njerëzve dhe krijon në to revolucione shpirtërore, duke i mbushur me dashuri dhe shpresë. Ky ka qenë edhe fakti i revolucioneve të kundërshtarëve të Islamit në përgjithësi, që kanë ndërruar mendje dhe kanë përqafuar Islamin, kur janë përballur me ajetet kur'anore. Pra, bukuria e Kur'anit ka qenë ajo që e ka mbajtur të gjallë vetë Kur'anin gjatë shekujve dhe ka qenë

objekt kënaqësie për njerëzit.

4- Nevoja për t'u falur. Njeriu, në thellësi të shpirtit të tij, në mënyrë të pavetëdijshme zotëron një ndjenjë, ku cilësi më të larta se të tijat, të një krijese tjetër, kërkon t'i arrijë dhe e ndien veten më poshtë se dikush tjetër që është me perfekt se ai. Për arsye të këtij perfeksionimi, krijesa perfekte bëhet objekt adhurimi për të.

Në rast se njeriu i afrohet gjithmonë e më shumë asaj, por që për të është e paarritshme, ajo shndërrohet në idhull dhe te njeriu, ndjenja e të qenit i varur prej saj, është gjithmonë e theksuar. Shpjegimi i mësipërm, në vetvete, nuk është gjë tjetër veçse ndjenja për t'iu falur një krijese të tillë kaq perfekte.

Ky lloj dimension i është induktuar në shpirtin e njeriut që në krijimin e tij, pavarësisht se tek njeriu shfaqet vonë dhe në fillimet e tij nuk dallohet qartë. Pra, në të vërtetë, ky dimension është forca motorike që vë në lëvizje njeriun në drejtim të përmirësimit

të tij total, duke përballuar vështirësi të ndryshme. Nevoja për t'u falur ka ardhur si domosdoshmëri që njeriu të zhvillohet e të këtë mundësi të përparojë pozitivisht. Por lind pyetja: Cilës krijese ka nevojë t'i afrohet njeriu dhe a e shikon atë gjithmonë perfekte, që ta këtë shembull në rrugët e jetës? Më parë ne kemi shpjeguar se vetë njeriu, midis krijesave të tjera, është një krijesë që ka një pozicion shumë të lartë, për veçoritë e tij shpirtërore dhe është krijesa më perfekte nga të gjitha. Në këtë kontekst, njeriu nuk ka nga të marrë shembull dhe të këtë idhull ndonjë prej tyre, sepse vetë ai është në një nivel më të lartë. Në bazë të kësaj logjike, përgjigjja është fare e qartë, që njeriu ka nevojë të arrijë vetë krijuesin e tij, që nuk është gjë tjetër përveç Zotit dhe për këtë arsye ai gjithmonë është në zhvillim. Pra, mund të themi se në bazë të dimensionit të nevojës për t'u falur, që ekziston në karakterin e tij që në lindje, njeriu, në një farë mënyrë, e njeh praninë e Zotit dhe lidhjen me të e ka në mënyrë të pavetëdijshme, por nuk është në gjendje ta sinkronizojë saktë se me çfarë ndjenje ka të bëjë. Me kalimin e kohës dhe me zhvillimin e këtij dimensionit në kahun pozitiv, njeriu gjithmonë e më tepër bëhet i vetëdijshëm për praninë e krijuesit të vet. Të gjitha dimensionet e karakterit të njeriut, duke përfshirë edhe ato më kryesoret, që trajtuam më lart, tregojnë qartë përpjekjen e njeriut për të arritur në një stad më perfekt nga ai që ndodhet, pra, kërkon përmirësimin e vetvetes në të gjitha dimensionet e karakterit të tij. Më lart ne treguam se përsosmëria e njeriut kishte lidhje të drejtpërdrejtë me nevojën për t'u falur dhe adhuroar Zotit. Në këtë kontekst, nxjerrim si përfundim se nevoja për t'u falur Zotit është nëna e të gjitha dimensioneve të tjera dhe baza e karakterit të njeriut. Ky fakt, edhe një herë, demonstroi qartë pozicionin e lartë të njeriut si krijesë e Zotit.

Konflikti midis logjikës dhe trupit

Ndonjëherë, midis instinkteve trupore dhe dimensioneve të karakterit, ndodhin konflikte: domethënë, dëshirat, që vijnë si rrjedhojë e instinkteve trupore, janë në kundërshtim me dëshirat që cilësitë e larta njerëzore i diktojnë njeriut. Këto, në gjuhën psikologjike quhen konflikte të brendshme midis logjikës dhe trupit.

Ka njerëz tek të cilët instinktet trupore, (që janë të përbashkëta midis njeriut dhe kafshës) mbizotërojnë, në krahasim me cilësitë e karakterit të tij në rast konflikti. Vendimet që do të marrë ky njeri do të diktohen nga instinktet e tij të theksuara.

E kundërta do të ndodhë me një njeri që i ka më të zhvilluara dimensionet e karakterit, ku përdor logjikën para se të marrë vendim. Nga një pikëpamje tjetër, që mbështetet edhe nga botëkuptimi islam, ky lloj konflikti mund të përkufizohet si konflikti midis shpirtit dhe trupit. Në raste të tilla, njeriu



duhet të veprojë në mënyrë të tillë që të mos dëmtohet identiteti i tij njerëzor, edhe në qoftë se instinkti kërkon një veprim të kundërt. Pra, në qoftë se njeriu ndodhet brenda një konflikti të tillë dhe vepron mbi bazën e diktatit të instinkteve të tij, ai e ka humbur humanizmin e tij dhe tashmë është shumë i ngjashëm me një kafshë. Në të vërtetë, veprimet e njeriut janë funksion i përbërë nga këto dy lloje dëshirash dhe nevojash. Në qoftë se njeriu nuk do që të bjerë pre e vendimeve të papajtueshme me identitetin e tij, rruga më e mirë për të është të mendohet duke gjykuar thellë në të gjitha dimensionet dhe pastaj të marrë një vendim. Për këtë gjë, njeriu duhet t'i mbajë të zgjuara dimensionet e larta të karakterit të tij, duke qenë i sigurt se, të tilla dimensione do ta çojnë në vendime të sakta dhe të pagabueshme.

Islami, pasqyrë e karakterit

Islami, në qendër të vëmendjes, ka mbarëvajtjen dhe zhvillimin e karakterit të njeriut, ose siç mund të thuhet ndryshe, Islami është feja e karakterit. Feja islame ka vendosur një ekuilibër midis të gjitha dimensioneve të karakterit dhe instinkteve të tij dhe asnjë nga këto nuk e mban të ndrydhur, duke krijuar kështu kushte të favorshme për zhvillimin e tyre paralelisht. Në mësimet islame mund të gjenden shumë shembuj që përmbajnë këshilla dhe instruksione për zhvillimin e secilit prej dimensioneve të karakterit. Të gjitha këto

tregojnë qartë se mësimet islame bazohen në karakterin e njeriut.

Po ashtu, në Islam, me të njëjtin kujdes dhe të njëjtën përpikëri trajtohen edhe instinktet trupore të njeriut. Arsyeja e kësaj vëmendjeje është se feja islame u dërgua nga Ai që e krijoi karakterin e njeriut dhe vetë njeriun, për ta udhëhequr atë deri në fund.


Këto tregojnë se ekziston një përputhje dhe harmoni e plotë midis krijimit (ekzistencës, gjenezës) dhe vendosjes së ligjeve të Islamit, pra, gjithçka është në ekuilibër të përsosur. Edhe Kur'ani i Madhëruar, në lidhje me këtë pikë, sqaron: "Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën All'llahu i ka krijuar njerëzit." (Sure "Er Rrum", ajeti 31)


Islami është një fe që nuk njeh ngjyrë vjetërsie, nuk plakët.

Plakje dhe dalje jashtë kohës do të kishim në rast se nuk do të ekzistonte karakteri i njeriut me të gjitha dimensionet e veta. Ligjet, traditat dhe zakonet, që shoqëri të ndryshme vendosin mbi njerëzit, do të bëhen pre e harresës dhe e zëvendësimit të tyre, nëse këto ligje nuk përputhen me karakterin e njeriut dhe nuk janë për ngritjen dhe zhvillimin e tij në përgjithësi. Përkundrazi, ligjet që vendosen në bazë të nevojave të karakterit të njeriut dhe i japin gjithmonë përgjigje atij në çdo kohë është e pamundur të vjetërsohen.

A mund të imagjinohet ndonjëherë që dimensionet e karakterit të njeriut, si për shembull kërkimi i së vërtetës, drejtësia, pastërtia njerëzore, guximi, e të tjera si këto, të bëhen të pavlera për njeriun?

Kjo është arsyeja që feja qiellore dhe ligjet e saj, me kalimin e shekujve, nuk vjetërsohen, por përkundrazi, vlera e saj mbetet përherë e vlefshme për njerëzit.





Të njihemi me suret e Kur'anit

20	Ta Ha	Mekase	135 ajete	1341 fjalë	5242 shkronja
----	-------	--------	-----------	------------	---------------

- Emërtimi: Një prej fjalëve të veçuara dhe një prej emrave të Profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!)
- Arsyeja e emërimit: Është ajeti i parë i kësaj sureje, i cili i drejtohet Profetit (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!), të cilit i zbriti Kur'ani dhe që ka një mesazh të rëndësishëm për të.
- Emrat të tjerë: Hakim, Kelim
- Përmbajtja e sures
 - Kur'ani dhe madhështia e tij, si dhe disa cilësi të bukurisë së Zotit
 - Historia e Musait (paqja qoftë mbi të!) dhe kundërvënia e tij ndaj Faraonit dhe magjistarëve të tij; mënyra devijuese e zgjedhur nga Samiriju për ta tërhequr popullin drejt politeizmit dhe adhurimit të vëçit; shpëtimi i robërve nga sundimi i Faraonit dhe mbytja e Faraonit me gjithë ushtri në det
 - Jeta e përtejme dhe disa aspekte nga Dita e Ringjalljes
 - Historia e hazreti Adem (paqja qoftë mbi të!) dhe e Havasë në Xhennet, dhe aventura e tyre me veset e shejtanit dhe zbritja e tyre në tokë
- Renditja e sures
 - Sipas renditjes së tubimit, është e 20-ta; sipas zbritjes, është e 44-ta e ka zbritur pas sures "Merjem" dhe para sures "Vakia".
- Historitë e sures: Musa (paqja qoftë mbi të!)-ajetet 6-99; Adem (paqja qoftë mbi të!)-ajetet 116-123.
- Fillimi dhe fundi
- Fillimi: "Ta, Ha. Ne nuk ta shpallëm Kur'anin për të të munduar ty."
- Fundi: "Thuaj: Secili është duke pritur; pra, prisni edhe ju se së shpejti do ta kuptoni se kush ishin ithtarët e rrugës së drejtë dhe kush e gjeti të vërtetën!"
- Mirësia e sures
 - Profeti i Islamit (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Ai që e lexon (a këndon) suren "Ta Ha", në Ditën e Ringjalljes fiton shpërblimet e emigrantëve (muhaxhirëve) dhe ensarëve (ndihmuesve, banorëve vendas të Medines)."



Një ravijëzim i

femrës shqiptare në kohëra

A ishte ndopak shqiptare femra e parë në Eden? Çfarëdo të ketë qenë, atëherë ajo nuk e kish dëgjuar maksimën budiste: "Shfarosni dëshirat, por paradoksalisht, megjithëse shumë më e lashtë, intuita i kish dhënë të kuptonte devizën e kundërt që zbaton

... i joni dëshira gjithnjë e më të reja". Kuptimin e vërtetë e kontradiktore e ka të qartë vetëm kush kupton se parë dhe as në shekullin e njëzetën ato nuk janë di nëse kam mjaftueshëm të drejtë të besoj se femrat doktrinuan historinë e të kaluarës sonë të përbashkët dhe në atë mënyrë që ndodhi, por kam shembuj të një në formë apo përmbajtje gjërat morën prirje nga tyre. Femra shqiptare ndërthurte gjithë emocionet e iversit të madh brenda një universi të vogël siç ishte rupi i tyre herë i brishtë e herë i regjur nga puna e lodhshme. Ninulla me zërin e ëmbël dhe pushka me tytë të ftohtë rrinin krahpërkrah mbi djepin e foshnjës, ashtu si mbi malet e lartë e të ashpër veshur me dëborë ku çelnin lule. Të ishte femër në Shqipëri do të thoshte zonjë shtëpie që mirëpret mysafirë, nënë e dhimbsur, bashkëshorte e përkushtuar, bareshë e druvare njëkohësisht. Në heshtje ato ngërthenin disa pozicione por veshur me një status, qenie që zgjon respekte edhe pse, jo gjithmonë, e ka gëzuar atë që meriton.

lhështia e bëmave heroike nuk është te dobja sepse kur janë të padobishme, nuk është te logjika sepse kur janë të palogjikshme. Aq më tepër që në kohëra tona është vepruar në mënyra të ndryshme, mirëpo, mençuria është çmuar njësoj. Shkrimtarja frënge Bouvoire shkruan: "Në fillim njeriu s'është asgjë, e ka të bëhet i mirë ose i keq sipas asaj se a e pranon lirinë e veta liria i parashtron në mënyrë absolute



dhe s'ka asnjë forcë të jashtme qoftë edhe vdekja të mund të shkatërrojë atë që ajo ka krijuar". Falë Zëne kemi brenda vetes si arketipe të mirën dhe të keq gjithashtu, ata mekanizma gati të përsosur siç është mendja e shpirti për të ndarë rrugët e për t'u orientuar drejtë. Në natyrë trupi dhe mendja zbulojnë që herët pushtetet e dy sunduesve, dhembjes dhe kënaqësisë, që në fakt, janë shprehje e robërisë së njeriut dhe jo e lirisë. Që nga çasti kur nisin e flasin ndjenjat tona, zë fill ai veprim që ne e quajmë të keqe morale, ai mosmiratim. Përmes prizmit që më vë përpara të qenurit larg në kohë gjykoj që femra shqiptare kuptoi shpejt nëse vlente apo jo flijimi i jetës për interes personal. Ky vetëmohim nuk i përket asaj logjikes së palogjikshme socialiste se e mira kolektive është më e rëndësishme se ajo e individit, përkundrazi lartëson individin, i cili si një forcë e vetme arrin të gjejë jashtë vetes të tjera vlera madhështore që kërkojnë përkushtohesh pasi janë baza të jetës së moralshme virtutshme.

Kalaja ilire e Shkodrës u ngrit mbi një femër dhe këmbë sa më gjatë mundi nga një tjetër femër. Rozë flijoi amësinë, dashurinë dhe dorëzoi përfundimish pasprovuar. Në këtë këndvështrim pasardhëset nuk gjejnë dot

hije të fshihen.

Më tej, Teuta mbart dobësinë e të mosparit dot se ç'po ndodhte njëkohësisht jashtë edhe brenda, kur komandantët kurdisnin sipas pëlqimeve dhe nuk i shqetësonte shumë mbretërimi i saj nderplotë. Pavarësisht marrjes së shtetit në ujëra jo të qeta, ajo nuk arriti dot të nuhaste trazirat e brendshme duke i lënë të gërryenin me lehtësi çfarë u dukej më penguese. Megjithatë kurrë armiku nuk kish qenë kaq përballë pushtetit, kurrë tradhëtia e besnikëve nuk kish qenë më në modë. Historisë i interesojnë përfundimet më shumë se sa argumentet. Ato gabime nuk sheshoheshin e as ajo thyerje nuk fshihej. Megjithatë, pa zvetnuar gruan, Teuta u burrërua dhe e prit rënien me fytyrë. Emblema kapitaliste na këshillon të punojmë për të fituar, të fitojmë për të shpenzuar, ndërsa ato që mbetën punuan për të fituar por fituan për t'u përjetësuar.

Pesha e heroinave të përbetuara që unë vetëm sa i preka, nuk zbeh kurrësesi të ashtuquajturat eminenca gri që kushdo i madh në detyrë mbret, princ a president i kushton ndoshta fagen më të rëndësishme të suksesit të tij. Ato zbutën zemrat e burrave të tyre kur nevojitej më shumë paqe dhe i ngurrosën ato pa kokëçarje kur qe fjala për guxim para kujt do të huaji që kërkon të të masë forcën. Kanë qenë ato diplomatet më të suksesshme që kanë hartuar politika me pasoja jetike, ato që kanë dhënë zemër për të mos u zbrapsur. Kjo nuk do të thotë aspak se Shqipëria ka parë vetëm dritë. Së fundmi, pesëdhjetë vjet diktaturë mirëfilli duket se janë ushqyer me zell po nga një femër që kishte vendosur të provonte rezistencën e dorës së saj të madhe në një vend të vogël, në një shtet që për fatin e saj të mirë totalitarizmi e kish ndryshuar në një glob të akullt të cilin mund ta vëzhgoje edhe nga ballkonet e secilës vile pushimi. Semiramida e Shqipërisë mendoj se u përdor me ndërgjegjen e vullnetin e saj në luftën e ftohtë që besoj se kish nisur më parë në rrethin e saj të ngushtë. Mjeshttrat që duan të të shmangin blejnë më herët atë që është në shtratin tënd... Ashtu si kapitalizmi i atëhershëm mund të ketë përpunuar first





ndoshta me jo shumë mundim sepse ajo e donte parinë
lloj kushti. Vetëkuptohet se qasja largpamëse “politikë
da një qerthulli të ngushtë” siç mund të jetë izolimi i dikujt
rkon mbështetje të shumëfishtë dhe ish-udhëheqësi ynë
u gjend i rrethuar nga shumë fije lidhëse kur në dekadën
e fundit të sundimit shfaqej gjithnjë e më i tërhequr. Lord
Bajron nuk e ka tepruar kur ka thënë: “Topat në luftë dhe
femrat në shtëpi thonë fjalën e fundit.”

Maskilizmi ofron mjete për progres, por me kusht që
t’ua shterrë shpirtin me vite e t’ua turbullojë identitetin
femrave. Duket se ia ka dalë mbanë përderisa sot
shumëkush guxon të lëshojë ca hapësira nga racioni i
vet që të mund të shtojë nuanca të një imazhi frymëzues.
Në këto kohë ka më pak domethënie nëse të tilla imazhe
mëzojnë nga jashtë apo nga brenda... Ky përparim që
është në suazën e dorës së njeriut sot po pëlqehet të arrihet
njete të neveritshme duke braktisur dinjitetin vetiak, por a
aktiset për sot a përgjithnjë?! Thuhet se të krishterët e kanë
syalizëm luçiferian, kurse poetët - grumbullim i barbarizmit
uar. Materialistët entuziazmohen me perspektivën që hap
arësisht çfarë vihet në lojë dhe me çfarë çmimi. Ajo e
jetuara mbeten gjurma më bindëse e shenjtërisë së tyre.

këtu qendron mundësia për ta provuar për të gjithë njerëzit dhe në të
gjitha kohërat.

Në ç’mënyrë u bënë ngadhënjyese ato femra që humbën qetësinë, lirinë, dhe madje, jetën
dhe në ç’botë qenë ato ngadhënjyese? Të këtilla ato qenë vetëm në një Botë Tjetër që
ndryshon tërësisht nga këtu. Mendësia e Botës Tjetër do të na duket aq e madhe sa fytyrat e
mëdha tragjike që në këtë botë luftuan dhe pësuan pa u shenjuar. Nuk janë të shumtë njerëzit
që veprojnë sipas ligjit të virtytit, por kjo pakicë e pafundme paraqet krenarinë e njerëzimit
dhe të çdo krijese njerëzore. Nuk janë të shumta çastet e jetës sonë kur veprojmë posaçërisht
sipas ligjit të detyrës, mirëpo, pa marrë parasysh këtë gjë, çastet kur ngrihemi mbi vetveten
duke lënë pas dore interesin dhe dobinë, paraqesin vlerën e vetme të pazhdukshme të
hierarkisë. Në këtë antitezë afirmohet femra shqiptare që nga nxjerrja prej Edenit deri në ditët
e sotme me dritëhijet si një qenie e dis’harmonisë. Në të vërtetë, reflektohet dualiteti midis
natyrës njerëzore ose kundërshtitë midis kulturës dhe civilizimit.

Alia Izetbegović thotë: “Mbartës i kulturës është individi. Mbartës i civilizimit është shoqëria.
Caku i kulturës është pushteti mbi veten përmes edukimit. Caku i civilizimit është pushteti
mbi shoqërinë përmes shkencës.”

Çfarë nuk do të ishte bërë pa femrat? Cila luftë do të zhvillohej? Cila vepër e madhe që
sot luan shumë rol? Çfarë do të ishte bërë me femrat më në qendër? Për dje, sot dhe
nesër ndoshta një politikë me më shumë vëmendje që më tepër se sa t’i ndëshkonte do
t’i shpërblente njerëzit. Bazuar në retorikat që përcjell aktualiteti, ftoj këdo të etiketuar si i
arsyeshëm për të nxjerrë përfundime mbi analiza konkrete për sa i përket asaj që është
meritë e dukshme e femrave ndaj të cilave janë treguar vullnetpakët jo rrallëherë. Mbase
ngjan oponentë teorike..., por dua ta theksoj zëshëm se diskriminimi sado pozitiv asnjë
femër asnjëherë s’do ta ndihmonte për t’u ngritur aq më pak për t’u rritur duke dalë me
kaste një hap përpara kur është fjala për konkurrencë gjoja për të kompensuar vakumet
që janë faj i së shkuarës.

Përgatiti : Anisa Proda



Hadithe

ezani

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Allahu më ka dhënë mua Fatihanë, ezanin, namazin me xhemat në xhami dhe ditën e xhuma."

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "S'ka dyshim se banorët e qiellit nuk dëgjojnë asgjë tjetër prej banorëve të tokës me përjashtim të ezanit."

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Kur shejtani dëgjon ezanin, largohet."

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Cilido që thërret ezanin e një namazi në rrugën e All'Ilahut me besim dhe me shpresë për t'u afruar tek Ai, All'Ilahu do t'ia falë të gjitha gjynahet e kryera."

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Kur ti e thërret ezanin dhe këndon ikametin, pas teje qëndrojnë dy rreshta me melekë dhe kur këndon vetëm ikametin, pas teje qëndron një rresht me melekë."

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Muezinët e ummetit tim në Ditën e Gjykimit do të jenë së bashku me të dërguarit, me të vërtetët dhe me dëshmorët."

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Muezinët janë besnikët e besimtarëve për namazin e tyre, për agjërimin e tyre dhe për trupat e tyre."

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Kur muezini thotë: "Eshhedu en la ilahe il-IAlI-llah" për atë dërgojnë paqë dhe lutje nëntëdhjetë mijë melekë dhe në Ditën e Gjykimit do të qëndrojnë nën hijen e Arshit derisa të mbarojnë llogaritë e të gjitha krijesave."

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "S'ka dyshim se trupat që do të ndalohen nga Zjarri janë ato të muezinëve."

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Shpërblimi i muezinit në mes të thërritjes së ezanit dhe ikametit është i njëjtë me shpërblimin e dëshmorit të lyer me gjak në rrugën e All'Ilahut."

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Kur t'ju lindë një fëmijë, thërritni ezanin në veshin e tij të djathtë dhe këndoni ikametin në veshin e tij të majtë."

Domethënia e fjalës *moral* (ahlak) në Kur'an

Fjala "moral", - arabisht "ahlak" - është shumës i fjalës "huluk", e cila përkufizon cilësinë e shpirtit. Ajo, gjithashtu, përkthehet si gjendje që i është ngjitur shpirtit, p.sh. përtacia etj. Çfarë mendojmë për këtë kur themi se diçka është ngjitur apo ka hyrë në shpirt? Kjo do të thotë se ne kryejmë vepra në pajtim me cilësitë e shpirtit tonë, ose thënë me fjalë të tjera - vepra është rezultat i gjendjes së shpirtit. Vepra e cila është kryer gati në mënyrë refleksive, pa kurrfarë mendimi, gjithashtu, është rezultat i gjendjes së shpirtit. Kur

ndonjë cilësi shndërrohet në automatizëm, atëherë, kjo është shenjë se ajo është ngjitur në ne.

P.sh. në mësimin e gjuhës së huaj ekziston një fazë kur nga pak mund ta përdorim, por kur duam diçka të themi, atëherë mendohemi mirë dhe në kokë e lidhim fjalinë dhe mbas kësaj e shqiptojmë. Kjo është gjendja kur njeriu akoma nuk e njeh gjuhën e huaj, por ekziston edhe gjendja kur gjuha e huaj njihet njësoj sikur gjuha amtare dhe në këtë rast, kur dalin fjalët, ato



dalin rrjedhshëm pa u menduar. Pra, për ndonjë cilësi ose gjendje, mund të themi se është rrënjësuar dhe vendosur në shpirt, atëherë kur veprat kryhen pa u menduar, në mënyrë refleksive.

Tani mund të parashtrohet pyetja: A thua morali është diçka që i përket qenies së njeriut apo arrihet nëpërmjet ushtrimit dhe përsiatjes?

Përgjigja është: Mundet të jetë edhe njëra edhe tjetra, kurse Islami ofron parime në të dyja rastet.

Në disa transmetime hasim se çfarë duhet

të punojë gruaja kur është shtatzanë, kurse qëllimi i këtyre punëve/veprave është që foshnjes t'ia mbjellë disa cilësi të cilat më vonë do të jenë mjaft të rëndësishme për të (foshnjen) kur të rritet. Gjithashtu, ekziston rekomandimi mbi edukimin pas lindjes (p.sh. që prindi të thotë Bismil-lah për fëmijën përpara ngrënies së ushqimit), kurse qëllimi i gjithë kësaj është ringjallja dhe arritja graduale e shprehive të mira. Pra, morali mundet të jetë i lindur dhe i fituar dhe kjo vlen si për cilësitë e mira ashtu edhe për ato të këqijat.

Çfarë nënkuptohet me nocionin moral (ahlak)? Nocioni moral përdoret në tri kuptime:

1. Domethënia gjuhësore e nocionit, pra, cilësia e shpirtit.
2. Ai nënkupton përshkrimin e ndonjë veprë nga jashtë, p.sh. kur dikush bën diçka dhe themi se ka kryer vepër të mirë.
3. Kur përdoret vetëm në kuptimin pozitiv, ndaj edhe themi se dikush është i moralshëm (ahlakli).

Cila është lënda e shkencës mbi moralin? Shkenca mbi moralin merret me cilësitë e mira dhe të këqija të personalitetit të njeriut dhe lëndë studimi i ka ato cilësi që mund të arrihen, e jo ato të cilat janë të lindura.

Cila është dobia nga kjo shkencë? Dijetarët thonë se dobia nga morali qëndron në:

A) Njohjen e cilësive të mira dhe të këqija.

B) Pas njohjes dhe klasifikimit të cilësive të mira dhe të këqija, pason përpjekja e ngjalljes së cilësive të mira dhe eliminimi i të këqijave.

Pra, morali është shkencë dhe vepër, edukatë dhe arsimim. Gjersa njeriu nuk i njeh cilësitë e shpirtit të tij dhe nuk është në gjendje t'i dallojë, atëherë, nuk do të mundet t'i shërojë edhe mangësitë e veta.

Pyetje: A thua njeriu anon kah morali sipas fitretit (natyrshmërisë) së tij, apo i imponohet si barrë të cilën duhet ta bartë? A thua nxitja për të mirë vjen nga brendia e njeriut, nga




batini i tij, apo nga jashtë, qoftë nga ana e shoqërisë apo fesë?

Përgjigjja në këto pyetje ishte shkak për dallimet në mendime. Disa dijetarë thonë se morali është i imponuar, kurse të tjerët se buron nga natyra e njeriu.

Para së gjithash, duhet të kërkojmë sqarimin kur'anor, por që në fillim të jepet të kuptosh se morali sipas përkufizimit të tij nuk lejon çfarëdolloj imponimi (ngase ai është cilësi e shpirtit, cilësi e krijuar).

Duke pasur parasysh faktin se në shpirt ekzistojnë edhe cilësitë e mira edhe ato të këqija, pyetja nëse morali është cilësi e shpirtit, nuk ka kuptim, por vetëm mund të parashtrahet pyetja tjetër: A thua cilësitë e mira vijnë nga shpirti i njeriut? Nëse p.sh. themi se morali i është imponuar njeriut, atëherë pyetja çon drejt asaj se a thua ndonjë njeri është i mirë ose jo. Për t'u përgjigjur në këtë pyetje duhet, së pari, të vendoset kushti, p.sh.: Dijenja, pas së cilës pyetja nëse njeriu i ditur a është i mirë, ka kuptim.

Përgjigjja e Kur'anit do të jetë e qartë pas



elaborimit në vazhdim. Kur'ani e shtron pyetjen e raporteve njeri-botë. Njeriu si pjesë përbërëse e botës është në kontakt të përhershëm me të. Lidhjet e tij me botën nuk janë absolutisht as të mira, por, as edhe të këqija; disa janë të mira, e disa janë të këqija. Le ta marrim p.sh. raportin njeri-automobil. Ky raport është i mirë nëse njeriu e përdor automobilin si mjet udhëtimi, por ama nëse hidhet përpara tij, atëherë, ky raport është i keq.

Gjithashtu, disa cilësi që janë shndërruar në nxitëse të shpirtit janë të mira, kurse të tjerat të këqija. Kjo bëhet mjaft e qartë kur e marrim parasysh lidhjen e pandërprerë të njeriut me botën e jashtme, përmes së cilës njeriu jep ndikime, por ama edhe vetë bie nën ndikimin e botës. Ndonjëherë shikimi në diçka ka ndikim të mirë, e ndonjëherë të keq; ndonjëherë është shenjë e dashurisë e ndonjëherë e urrejtjes, kurse ndonjëherë mundet të jetë shikim, i cili do të na

shkatërrojë jetën në të dy botët.

Disa transmetime na tregojnë se një lloj përgojimi kryhet përmes syve, përkatësisht, përgojohet me sy. Prandaj, All'illahu i ndjek dhe sheh gabimet që i bëjmë me lëvizjen e syve. Kur'ani famëlartë na i shfaq disa parime:

1. "All'illahu është Krijues i çdo sendi dhe Ai është mbikqyrës ndaj çdo gjëje".(Ez-Zumer, 62);
 2. Vepra e Zotit është e bukur: "Ai që përsosi krijimin e çdo sendi..."(Es-Sexhde, 7);
 3. Gjithçka që është krijuar lëviz drejt përkryerjes si synim, ndaj edhe ka udhëzim të jashtëm dhe të brendshëm.
- "(Musai) Tha: "Zoti ynë është Ai që çdo sendi i dha formën e vet, pastaj e udhëzoi atë". (Ta Ha, 50).

Shejh Akbar Eydi


Përkthyer nga Prof. Nuredin Ahmedi
(Zoti e mëshiroftë!)



Feja është lidhja në mes

VAHJIT DHE AKLIT

Nëse njëra nga këto të dyja mungon, atëherë nuk ka besim (fe) të kompletuar. I përmendëm katër mënyra se si intelekti i vjen në ndihmë fesë. Katër ajetet e sures "Jasin" pohojnë se pa ndihmën e intelektit nuk do të ishte dini (feja, besimi), që pejgamberët e Zotit pa intelekt nuk do të mund ta përmbushnin misionin e tyre. Tani do të shohim se si Vahji (Shpallja) e Zotit e përkrah intelektin. Kur Vahji e përkrah intelektin, i thotë që bota e materies në të cilën jeton është mjaft e kufizuar dhe ia tërheq vërejtjen që të mos mendojë se pas kësaj bote nuk ka tjetër. Përkundrazi, pas tij ekziston një botë më e përgjithshme dhe e fuqishme se sa bota materiale; ngase bota materiale është vetëm një hallkë në krijimin që ka bërë Zoti. Por kjo nuk është vetëm pohim i Vahjit, ai hap pas hapi e shpie intelektin që ta shohë se sa e gjerë është Mbretëria e Zotit. Dhe kur Vahji i tregon intelektit shkallët e mbretërisë së Zotit, intelekti do ta pranojë këtë. Në mes të dinit dhe aklit (logjikës, intelektit) ekziston, pra një lidhje e pandërprerë e cila është e domosdoshme që të mund të ekzistojnë të dyja. Asnjëra nga to, kur të niset në pushtimin e mbretërisë qiellore, nuk mundet pa njëra-tjetrën. Kur të kapen për dore, kurrë nuk lëshohen. Sikur





të ndaheshin, asnjëra nga ato nuk do të mund të shkante më tej vetë.

Mirëpo, ekziston një dallim ndërmjet vahjit dhe intelektit. Kur intelektit i trajton krijesat e kësaj bote, ai i sheh nga tri këndvështrime.

1. I shqyrton ndodhitë të cilat i nënshtrohen gjykimit të tij. Mund të konstatojë se parimet e kësaj bote janë të tilla që me to mund të shërblehen edhe jobesimtarët edhe besimtarët. Meqë intelektit ka fuqinë e njohjes së ligjeve të Zotit në këtë botë, i hulumton një nga një dhe vendos lidhje mes tyre, dhe më pas, në vend të shërbëtorit të thjeshtë shndërrohet në sundues të ligjit në këtë botë. Ja si funksionon kjo: p.sh. jashtë është ftohtë dhe trupi kërkon mënyra se si t'i kundërvihet të ftohtit, por intelektit i tij kupton që në tokë ekziston gaz dhe naftë, të cilat mund të përdoren si karburante dhe kësaj, t'i kundërvihet natyrës e cila dëshiron ta shkatërrojë. Kështu, bëhet udhëheqës/sundimtar i ligjeve. E nëse është verë, intelektit kërkon ventilatorë, i lidh

ato me rrymën dhe sërish bëhet sundues i ligjit nëpërmjet së cilës i kundërvihet të nxehtit. Intelekti, gjithashtu, e ka shkurtuar largësinë në mes vendeve të largëta dhe kësaj ka zbuluar mjete transporti konforte si dhe kompjuterin.

"A nuk e dini ju se All'illahu nënshtroi për të mirën tuaj ç'ka në qiej e ç'ka në tokë dhe plotësoi ndaj jush të mirat e Tij të dukshme e të fshehta..." (Lukman, 20).

2. Kjo është ajo që intelektit mund ta arrijë, por ekzistojnë çështje që janë të palogjikshme dhe të pamundura për intelektin; të bashkosh ekzistencën dhe mosekzistencën në një vend (që gota edhe të jetë edhe të mos jetë në këtë vend) apo pohimi se diçka njëkohësisht mund të jetë edhe e bardhë edhe e zezë. Intelekti është, pikërisht, ai që do të thotë se një gjë e tillë është e pamundur.

3. Intelekti njeh parimet e ekzistencës së tij, por më thellë nuk mund të depërtojë. Kur njeriu thotë se nuk ka kurrfarë mënyre ta

arrijë qëllimin e kuptimit të tij, intelekti do të thotë se për këtë ka mundësi dhe se ai do t'ia tregojë. Në këtë rast intelekti thotë: "Zoti e ka krijuar vahjin dhe peygamberllëkun të cilat ty o njeri do t'i shndërrisin ato shtigje ku ka terr (errësirë), për të cilat nuk je në gjendje vetë asgjë të njohësh". Vahji, pra, është kandili ndriçues i cili i hap horizontet dhe e ndriçon rrugën e mëtejshme.

T'i përsërimin edhe një herë tri tezat mbi lidhjen mes intelektit dhe Shpalljes:

- Sikur të mos ekzistonte intelekti, Vahji nuk do të kishte kujt t'i drejtohej.
- Intelekti është ai që i mbledh dijet nga Vahji dhe më pas i kahëzon.
- Intelekti konfirmon se çdo parim jetësor në botë është ashtu i kahëzuar që ose na e largon dëmin nga ne ose na jep ndonjë dobi.



Në fillim fare vërejtja e masës drejtuar dikujt që pohon se është peygamber është i drejtë. Peygamberët atëherë përgjigjen se në një fazë edhe ata janë të njëjtë, mirëpo më pas, peygamberët sjellin mu'xhize (mrekulli). Mu'xhizeja është ajo që njerëzit e thjeshtë nuk mund ta bëjnë, sepse ajo i tejkalon mundësitë e tyre. Sikur mu'xhizeja të ishte nga ligjet e rëndomta që mbretërojnë tek njerëzit, atëherë çdokush do të mund ta bënte. Meqë peygamberët mund të bëjnë mu'xhize, ndërsa njerëzit jo, ky është argument se peygamberët i përkasin një bote tjetër. Në këtë mënyrë, intelekti i njerëzve del në skenë dhe vërteton se peygamberët me të vërtetë janë ata që mund të bëjnë diçka që njerëzit e rëndomtë nuk mund ta bëjnë. Kjo është ndihma që intelekti (akli) ia ofron Vahjit (Shpalljes), ndërsa nga ana tjetër Vahji "e merr për dore" intelektin dhe i flet se kjo botë e materies është vetëm një hallkë në tërë zinxhirin e Krijimtarisë së Zotit. Tërë kjo, aklin (intelektin) e pret në Jetën e Amshuar, ndaj tani duhet të përkujdesemi për të. Qysh në këtë botë (dynja) duhet t'ia përgatisim vetvetes furnizimin për Botën Tjetër (Ahiretin). Prandaj intelekti nuk duhet të mendojë se ligjet e kësaj bote janë krijuar vetëm për të dhe vetëm ai duhet t'i marrë furnizimet apo begatitë e kësaj bote.



Hazreti Merjemja

(paqja qoftë mbi të!)

një shembull për t'u ndjekur

"O Merjem, vërtet All'Ilahu ty të ka zgjedhur, të ka pastruar dhe të ka zgjedhur prej gjithë grave të botës". "O Merjem, lutju Zotit tënd dhe bëj sexhde dhe përulu me të përulurit." (Sure Ali Imran, 42-43).


Në tregimin e Merjemes (paqja qoftë mbi të!) njihemi me disa qëllime dhe ngjyra që përmban shkenca, si dhe të vërteta të habitshme të cilat shkenca nuk i ka njohur vetëm e vetëm në këto kohë. Me qëllim që të sqarohet më mirë ky imazh, le të fillojmë me tregimin që nga fillimi i tij. Imrani dhe gruaja e tij nuk e kanë patur fatin e mirë të gëzohen me fëmijë që në fillim të jetës së tyre, sepse e shoqja e Imranit ka qenë sterile (nuk lindte fëmijë). Po ashtu, i shoqi i saj mbërriti në moshë të thyer, por ajo nuk i dorëzohej dëshpërimit. Ajo i kërkonte All'Ilahut të Madhëruar në lutje kur u falte, me dëshirë të madhe që ta begatonte me një fëmijë. Ajo u betua, se nëse do të lindte fëmijë, do ta vendoste shërbyes në shtëpinë e bekuar (Bejtul Makdis). Vërtet, All'Ilahu i Madhëruar iu përgjigj lutjes së saj, po ashtu, lutjes së të shoqit dhe ajo mbeti shtatzënë me fëmijën e shumëpritur. Çdo ditë që kalonte, ajo gëzohej më shumë dhe lumturia dukej në fytyrën e saj. Në kohën e shtatzanisë ndodhi një fatkeqësi. I shoqi i saj, Imrani, vdiq dhe e la të vetme. Dëshira e saj ishte që të shihte fëmijën që do të lindte, me qëllim që t'ia lehtësonte asaj dhimbjet dhe lëndimet kur ta shihte atë duke bërë detyrat fetare në Bejtul Makdis, i cili konsiderohet vendi i zbritjes së të Dërguarve. Por ajo që ndodhi, i theu të gjitha ëndrrat dhe i dogji

të gjitha përfytyrimet, mbi të cilat kishte ndërtuar shpresat e saj. Dita e lindjes filloi të afrohej dhe ajo priste me padurim. Por ajo lindi vajzë në vend të djalit që ajo u betua se do ta linte në shërbim të All'Ilahut të Madhëruar. Me mundimet që i pushtonin zemrën, ajo tha: "O Zoti im, unë linda vajzë (dhe mashkulli nuk është si femra)" (Sure "Ali Imran", ajeti 36). Këtu po japim një sqarim nga ana shkencore, e cila (shkenca) ka konstatuar se ka më shumë së njëqind dallime mes mashkullit dhe femrës, përse i përket anës fiziologjike, shpirtërore dhe psikologjike. Kjo gjë, bëri që thirrja për barazi mes burrit dhe gruas të vështirësohet dhe të goditet me "dhimbje të forta në kokë". Pastaj tha: "Unë e quajta Merjem!". Pas lindjes së foshnjës, e ëma e saj vdiq dhe ajo mbeti e vetme dhe jetime duke humbur dashurinë dhe ngrohtësinë e nënës dhe babait të saj. Për të u përkujdes Zekerija (paqja qoftë mbi të!).

Zekerija, ishte burri i tezes së Merjemes (paqja qoftë mbi të!) dhe ai mori përsipër të kujdesej për të. Kur'ani na e thotë mjaft qartë, se për Merjemen u përkujdes Zekerija. Sa herë që Zekerija hynte në vendin që ajo falej, shihte furnizime dhe mirësi hyjnore, dhe i thoshte: "O Merjem, nga të kanë ardhur këto?! Ajo i thoshte: - Nga All'Ilahu i Madhëruar, sepse All'Ilahu i jep të mira atij që do dhe pa llogari. Kur'ani

vërteton përkujdesjen e Zekerijas (paqja qoftë mbi të!) për Merjemën, ndërkohë që ka disa libra që thonë se Jusuf Nexhari (Jozef Zdrukthëtari), ka qenë kujdestari i saj. Kjo është në kundërshtim me Kur'anin dhe me historinë e saktë. Në zbatim të betimit, Merjemja, jetonte në shtëpinë e bekuar (Bejtul Makdis), por ama me një mënyrë të caktuar. Për atë përgatitën një dhomë në pjesën e sipërme të faltores. Në atë dhomë, ajo i bënte ibadet (adhurim) All'Ilahut të Madhëruar me qëllim që betimi të plotësohej. Atë dhomë, Kur'ani e quan mihrab (vendi i faljes), sepse ajo ndodhej në brendësi të xhamisë (mesxhidit) dhe se

siç e shohim në ajetin: "Sa herë që Zekerija hynte tek ajo në Mihrab, gjente tek ajo mirësi dhe i thoshte: "O Merjem nga është ky ushqim?!" Ajo thoshte: "- Ajo është prej Zotit. Vërtet, All'Ilahu i jep mirësi atij që do pa llogari". (Sure "Ali Imran", ajetet 3-7). Një ditë, kur po lahej dhe pasi veshi rrobat e saj, sheh një djalë të bukur që qëndronte para saj. Asaj iu drodh trupi prej frikës dhe i tha: "- Unë i kërkoj mbrojtje All'Ilahut prej teje nëse je që i frikësohesh Atij (pra më lër të lirë)!". (Sure "Merjem", ajeti 18). Pra, nëse i frikësohesh All'Ilahut të Madhëruar, atëherë largohu nga unë. Por ai djalë nuk ishte tjetër, veçse Xhebraili, të cilin e dërgoi



zonja Merjem e bëri vend për falje dhe për lutje. Dhe pikërisht në këtë vend melekët bisedonin me të dhe i thoshin: "O Merjem, vërtet All'Ilahu ty të ka zgjedhur, të ka pastruar dhe të ka zgjedhur prej gjithë grave të botës. O Merjem, lutju Zotit tënd dhe bëj sexhde dhe përulu me të përulurit." (Sure Ali Imran, 42-43). Po në këtë dhomë, asaj i vinin sofrat e ushqimit vazhdimisht, derisa Zekeria u habit dhe i tha asaj duke e pyetur me respekt: "O Merjem, nga të ka ardhur ky ushqim?!" "Ajo i tha: - Nga All'Ilahu". Ardhja e ushqimit ka qenë e vazhdueshme

All'Ilahu i Madhëruar tek ajo që ta begatojë me një fëmijë të zgjuar. Kur besniku, Xhebrail (paqja qoftë mbi të!) i tha: "- Dhe kjo është çështje e kryer.", Merjemja e ndjeu foshnjën që lëvizi në barkun e saj. Menjëherë, ajo doli e mbuluar në fytyrë dhe nuk dinte nga të shkonte. Ishte në gjendjen më të rëndë të frikës dhe të trishtimit dhe shkakun ajo e dinte, sepse e njihte popullin e saj dhe i njihte forcat e tyre për të përhapur këtë ndodhi dhe se ata do të përhapnin shpifje për të. Ajo ishte e pastër dhe e ndershme.

Përgatiti: Fatme Chehab



Kiameti

Nga vendqëndrimet e vështira të Botës Tjetër është dhe Kiameti, tmerri i tij i madh, mbase më i madhi i tmerreve. Ai është frika shumë e madhe, të cilën All'llahu i Madhëruar e përshkruan kështu në Kura'n:

“Çështja e tij (se kur do të ndodhë) është preokupim i rëndë (për krijesat) në qiej e në tokë. Ai (Kiameti) nuk ju vjen ndryshe, vetëm befas.” (Sure El A'raf, 187)

Pra, Kiameti është një gjë shumë e vështirë dhe e rëndë për banorët e qiellit dhe të tokës, si për melekët, xhindet dhe njerëzit dhe se do të vijë në befasi apo papritur.

Kutbi Rauendi transmeton nga Imam Aliu se Isai, djali i Merjemes (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur është Kiameti?”. Xhebraili pësoi një tronditje shumë të madhe sa që i ra të fiktë për një kohë dhe pasi u zgjua tha: “O Shpirti i All'llahut, i pyeturi nuk është në dijeni

më shumë se ai që pyet dhe lexoi ajetin e sipërpërmendur.”

Shejh Ali bin Ibrahim El Kummij transmeton nga imam Bakiri: “Një ditë Profeti i Zotit ishte i ulur dhe tek ai kishte ardhur Xhebraili, i cili sapo deshi të largohej, shikoi lart nga qielli dhe i ndryshoi ngjyra e fytyrës sa që iu bë shumë e verdhë, pastaj erdhi në vete dhe iu drejtua Profetit. Të njëjtën gjë bëri dhe Profeti. Ai shikoi nga qielli, andej nga shikoi Xhibraili, dhe u duk diçka që po mbulonte Lindjen dhe Perëndimin, sikur të ishte diçka shumë e vogël nga toka. Më pas ai tha: “O Muhammed unë jam i dërguar i All'llahut tek ty dhe ke të drejtë të zgjedhësh: të jesh melek i dërguar është më e dashur për ty, apo të jesh njeri i dërguar? Profeti e pa Xhebrailin që i ishte kthyer ngjyra e fytyrës. Xhebraili tha: “Më mirë të jesh njeri i dërguar.”

Profeti tha: “Do jem njeri i dërguar.” Meleku ngriti këmbën e tij të djathtë dhe e vendosi në mes të qiellit të parë

të dynjasë, pastaj ngriti këmbën tjetër dhe e vendosi në mes të qiellit të dytë të dynjasë. Kështu vazhdoi derisa arriti në qiellin e shtatë dhe në çdo qiell që ngjitej zvogëlohej sa u bë si një shpend i vogël. Profeti u kthye nga Xhebraili dhe i tha: Të pashë shumë të frikësuar dhe nuk kam parë dikë më të frikësuar se ty me ndryshimin e ngjyrës. Ai tha: “O i Dërguari i All’llahut mos më lëndo, a e di se kush ishte ai?” Profeti iu përgjigj: “Jo.”

Xhebraili tha: Ai ishte Israfili, e ka penguar All’llahu që të zbresë nga vendi i tij që kur ka krijuar Zoti qiejt dhe Tokën. Kur e pashë se po zbriste mendova se do të ndodhë Dita e Kiametit, prandaj më ndryshoi ngjyra e fytyrës. Kur pashë se me çfarë të ka përzgjedhur All’llahu mu rikthye ngjyra dhe vetja ime përsëri.”

Në një transmetim tjetër thuhet: “Melekët e afërt, qielli, toka, era, malet, detet apo diçka tjetër frikësohen nga dita e Xhuma se mos ndodhë Kiameti në këtë ditë.

Autori thotë: “Frika e qiejve dhe Tokës dhe çdo gjëje që përmendet është frika e banorëve të tyre sikurse e thonë edhe komentatorët në kuptimin e ajetit: “Çështja e tij (se kur do të ndodhë) është preokupim i rëndë (për krijesat) në qiej e në tokë.”



Transmetohet se Profeti kur përmendte Kiametin e forconte zërin dhe i skuqeshin faqet.

Shejh El Mufidi në librin “El Irshad” thotë: “Kur u kthye Profeti nga Tebuku në Medine, erdhi tek ai Amr bin Muadhi i pikëlluar. Profeti i tha: Bëhu mysliman, o Amr, që të të ruajë All’llahu i Madhëruar nga frika e madhe, (frikë që është më e madhe se çdo frikë tjetër). Ai tha: “O Muhammed, cila është frika e madhe, sepse unë nuk frikësohem?” Profeti (paqja dhe bekimi i All’llahut qoshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) iu drejtua duke



i thënë: “O Amr, nuk është ashtu sikurse e mendon dhe e llogarit ti, sepse një thirrje e vetme u bëhet njerëzve dhe të gjithë të vdekurit do të ringjallen dhe të gjallët të gjithë do të vdesin. Pastaj ata thirren përsëri me një thirrje tjetër dhe të gjithë ringjallen dhe vendosen në rreshta. Qielli do të çahet, toka do të shkatërrohet, do të bien malet pjesë-pjesë dhe do të ngrihet zjarri si malet, e nuk do ngelë asgjë që ka shpirt që nuk do t’i preket zemra e tij dhe do të kujtojë gabimet e veta, do të mendojë për veten e vet, përveç asaj që do All’llahu i Madhëruar. Po ti, ku je nga kjo, o Amr?”

Amri tha: “Me të vërtetë, unë po dëgjoj për një gjë të madhe. Ai besoi në All’llahun dhe në të Dërguarin e Tij. Me të besuan të gjithë që ishin nga populli dhe u kthyen tek fisi i tyre.”

Autori thotë: “Nga kjo ngjarje tregohet zemra dhe trimëria e Amrit. Thuhet se ai ka qenë një nga trimat e njohur dhe ka udhëhequr hapjen e shumë vendeve

joislame...”

Transmetimet në këtë aspekt janë të shumta, nga të cilat përfitohet dhe nxirret konkluzioni se vështirësitë e Ditës së Kiametit (Ringjalljes) janë shumë të mëdha. Vështirësia e kësaj dite është aq e madhe, sa që të vdekurit në Berzah dhe në varr gjithashtu do të frikësohen, sepse disa të vdekur që janë kthyer në jetën e kësaj bote me lutjet e të zgjedhurve të All’llahut të Madhëruar për shkak se ndjesia e tyre ka qenë shumë e bardhë dhe kur janë pyetur për arsyet e kësaj kanë thënë: “Kur u urdhëruam për në jetë menduam se erdhi Dita e Ringjalljes. Prandaj, u zymtësua ndjesia jonë nga frika e vështirësisë dhe e frikës në Ditën e Kiametit (Ringjalljes).”


¹ Autori thotë në përmbledhje: me fjalën “zbritur” ka për qëllim se nuk ka zbritur i vetëm dhe pa lajmëruar sikurse ka zbritur në këtë rast. Kjo për të mos rënë në kundërshtim me atë që thuhet për zbritjen e tij me Xhebrailin dhe Mikailin për shkatërrimin e popullit të Lutit apo në raste të tjera sikurse transmetohen. Zoti e di më së miri.

Panairi i 12-të i Librit në Tiranë



Më 12.11.2009 u hap Panairi i 12-të i Librit në Pallatin e Kongreseve. Siç do vit, Fondacioni i Kur'anit mori pjesë me stand në librat e tij. Standi jonë u vizitua nga njerëz të njohur të vendit tonë. Këtë vit u vrenjtë një fluks i madh lexuesish që shfaqën interes për librat fetarë dhe ne besojmë se është rezultat i botimeve të librave të rinj. Ne shpresojmë që në vitin e ardhshëm të jemi sërish me botime të reja të niveleve të larta për t'u dhuruar më shumë kënaqësi lexuesve dashamirës të teksteve islame.





Kur'ani famëlartë është mrekullia e përjetshme e Pejgamberit tonë, Muhammedit (paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të!) dhe libër që sfidon tërë botën: "Thuaj: 'Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindet për të hartuar një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri - tjetrin.'" (Sure "El Isra", ajeti 88)

Ai është kushtetutë që Zoti i Madhëruar e ka zbritur për të gjithë njerëzit: "Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje..." (Sure "En Nahl", ajeti 89)

Përveç kësaj, Kur'ani është plot rrëfime që kanë ndodhur mijëra vjet më parë. Qëllimi i këtyre rrëfimeve është që myslimanët të marrin mësim prej tyre, sepse i lumtur dhe i shpëtuar është ai që merr mësim prej të tjerëve. Kur Kur'ani thekson dënimet që i kanë përjetuar popujt e kaluar punëkëqinj në këtë botë dhe se në Ahiret do të hyjnë në Xhehennem, ka për qëllim që ne të largohemi prej veprave të ngjashme me veprat e tyre, të bëhemi të lumtur e të kënaqemi me jetën e kësaj bote duke bërë vepra të mira dhe të fitojmë lumturinë e përjetshme në Jetën Tjetër.

I nderuar lexues, kur të lexosh një nga këto rrëfime, mundohu që të përfitosh sa më shumë! Zoti e ndihmon robin e vet, përderisa robi ecën në rrugën që ia ka caktuar Kur'ani famëlartë dhe më i madhi Pejgamber, Muhammedi (paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të!)

Kur'ani, mrekullia e përjetshme e Profetit Islam

Kur'ani është libër mbi mendjet e njerëzve. Deri më sot, askush nuk ka mundur të sjellë një libër të njëjtë si ai. Ky libër i bekuar mes të gjitha mrekullive të Profetit (paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të!) konsiderohet dokumenti më i fortë e i gjallë për profetësinë e Profetit të fundit, sepse Kur'ani është mrekulli "folëse", "e përjetshme", "mbarëbotërore" dhe "shpirtërore". Përsa i përket të qenit e tij mrekulli "folëse", themi kështu sepse mrekullitë e profetëve të tjerë të mëparshëm nuk kanë qenë të tilla, pasi ata kanë patur nevojë për praninë e Profetit (paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të!) që t'u flasë njerëzve për mrekullinë e tij e me të, të ballafaqohet me ta. Edhe mrekullitë e tjera të Profetit tonë Muhammedit (paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), me përjashtim të Kur'anit, kanë qenë të tilla, ndërsa Kur'ani është mrekulli "folëse". Nuk ka nevojë për njohje, ai fton vetë për veten e vet, ai vetë i fton kundërshtarët për ballafaqim, i mposht ata dhe del triumfues nga mejdani i sfidimit. Ai i sfidon njerëzit sot, njësoj siç i sfidoi ata që ishin në fillim të shpalljes. Ai është feja, mrekullia, ligji dhe dokumenti që konstaton dhe vërteton hyjninë e ligjit. Përsa i përket "përjetësisë" dhe "mbarëbotësisë", Kur'ani i ka shkërmoqur fortifikatat e kohës e të vendit dhe ka dalë mbi ta.



Mrekullitë e profetëve që erdhën para Profetit Muhammed (paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) deri edhe disa mrekulli të tjera të Profetit, përveç Kur'anit, janë të shënuara në një pjesë të caktuar të kohës dhe kanë ndodhur në një sipërfaqe të caktuar vendi dhe para një grupi të kufizuar njerëzish, njësoj si mrekullia e Hazreti Isait (paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!), kur foli në djep dhe kur ringjalli të vdekurit. Është e qartë se ndodhitë janë të kushtëzuara me kohën dhe me vendin; sa më shumë t'i largohemi në kohë, aq më shumë zbehet pamja e tyre. Kjo është specifike e çështjeve kohore. Mirëpo Kur'ani nuk ka lidhje me kohën e as me vendin. Ai na ndriçon ne sot, njësoj siç ndriçonte arabët e paditur para disa shekujve. Jo vetëm kaq, kalimi i kohës ia shtoi aftësitë njeriut në dije e në mundësi, me qëllim që ai të përfitojë më shumë prej Kur'anit se sa përfituan të parët. Ajo çka nuk është e lidhur me kohën dhe vendin, përmban elementë të vazhdimësisë, përjetësisë e të gjerësisë së rrethit mbarëbotëror dhe të përjetshëm.

Përsa i përket, cilësisë "shpirtërore" që ka Kur'ani, këtë e kuptojmë kur shohim mrekullitë e profetëve të mëparshëm, e shumta e të cilave ka qenë "trupore", p.sh. shërimi i sëmundjeve të rënda trupore, të folurit e fëmijës në djep... Këto kanë pasur destinacion pjesët e trupit. Kurse Kur'ani ka destinacion zemrat dhe shpirtat. Ai ka lidhje me shpirtat dhe logjikën e njerëzve. Pra, duket qartë dallimi i kësaj mrekullie nga mrekullitë e tjera trupore.



Vallë, a sfidoi Kur'ani?



Kur'ani i fton njerëzit për ballafaqim në disa sure të tij:

a) Në suren "Isra", ajeti 88: "Thuaj: 'Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindet për të hartuar një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri-tjetrin.'"


b) Në suren "Hud", ajetet 13 dhe 14: "Nëse ata thonë: 'Ai e ka trilluar atë!' Thuaju: 'Sillni dhjetë sure të ngjashme të trilluara dhe thirrni në ndihmë kë të mundni, përveç All'lahut, nëse thoni të vërtetën!' 'E, nëse nuk ju përgjigjen, atëherë ta dini se ai (Kur'ani), ka zbritur me dijen e All'lahut dhe se s'ka Zot tjetër përveç Tij. Prandaj, a jeni ju myslimanë?'"

c) Në suren "Junus", ajeti 38: "Ata thonë: 'Ai (Muhammedi) e ka trilluar atë (Kur'anin)', thuaju: 'Atëherë, sillni një sure të ngjashme me të dhe thirrni kë të mundni, përveç All'lahut, nëse thoni të vërtetën.'"

d) Në suren "Bekare", ajeti 23 dhe 24 për të cilat do të flasim.

Në këto ajete, Kur'ani sfidon me qartësi e forcë; Ai është argument për të vërtetën e tij. Ai nuk ka mjaftuar në ballafaqimin e tij me njerëzit që të sjellin të ngjashëm me të, por ai i nxiti ata për këtë gjë. Shprehjet e nxitjes i gjejmë në thëniet e Tij të Madhëruara: "nëse jeni të sinqertë"... "Sillni dhjetë sure të ngjashme të trilluara"... "Thuaj, sillni një sure të ngjashme"... dhe thirrni kë të mundni, përveç All'lahut" ...Thuaj: "Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindet..." "nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të" ..."ruajuni prej zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët" ..."Nëse nuk mundeni, dhe kursesi nuk do të mundeni"

Duhet përmendur se sfida e Kur'anit nuk është e kufizuar e as e përcaktuar për një kohë apo vend. Kjo sfidë vazhdon edhe në ditët e sotme.



O Isa, Unë jam Zoti yt dhe Zoti i baballarëve të tu. Emri im është Vahid (i Vetmi). Unë jam Krijuesi i vetëm që ka krijuar çdo gjë. Çdo gjë është krijesa Ime dhe gjithçka kthehet tek Unë.

O Isa, sipas urdhrit Tim, ti je Mesihu; me lejen Time, do ta krijosh shpezën nga balta dhe do ta ringjallësh të vdekurin përmes fjalës Time, prandaj, frikësohu prej Meje. Nuk mund të gjesh asnjë strehë tjetër, përveçse tek Unë.

O Isa, të këshilloj që të jesh i mëshirshëm dhe i dashur, në mënyrë që të bëhesh i denjë për udhëheqje dhe të kërkosh kënaqësinë Time. Kudo që të jesh, je i uruar në moshën madhore dhe në fëmijëri. Dëshmoj se ke ardhur në këtë botë prej një gruaje të re që më shërbente (adhuronte). Mundohu që të jesh sa më pranë Meje përmes namazeve. Mbështetu tek Unë, që të jem i mjaftueshëm për ty. Mos e kthe fytyrën nga Unë dhe mos e miqëso tjetrin, sepse do të të lë krye në veti.

O Isa, bëhu i durueshëm kundër fatkeqësive. Pranoje caktimin dhe paracaktimin Tim. Bëhu ndër ata me të cilët jam i kënaqur, ata janë që më binden dhe nuk më kundërshtojnë.

O Isa, më përmend me gjuhën tënde dhe më duaj me zemrën tënde.

O Isa, zgjohu prej gjumit pas mesnate dhe përforcoje zemrën tënde me frikë.

O Isa, kaloji netët në adhurim, nëse dëshiron kënaqësinë Time dhe kaloji ditët e etshëm (me agjërim) për hir të ditës kur do të jesh në nevojë.

O Isa, ti do të merresh në pyetje; prandaj, mëshiroje të dobëtin, siç të mëshirova ty dhe mos e qorto jetimin.

O Isa, vajtoje gjendjen tënde në vendet e pastra, shko në vendet e namazit (mesxhid) dhe bëje veten që të ndjesh kënaqësinë e të përmendurit Tim, sepse, sjellja Ime ndaj teje është e bukur.

O Isa, sa popuj kam ndëshkuar e asgjësuar për shkak të gjynaheve të tyre; ndërsa, ty të kam mbrojtur prej mëkatëve të tilla.

O Isa, kalo mirë me të dobëtin; drejtoji sytë e tu të pafuqishëm kah qielli dhe më thirr Mua. Padyshim që Unë jam afër teje. Më përmend duke mu lutur me dëshirë të zjarhtë. Pikëllimi dhe vuajtja le të bëhen një (mos mendo askënd tjetër përveç Meje). Kështu do ta pranoj lutjen tënde.

O Isa, mos të të mashtrojë ty gjendja e mizorit që ha e pi nga furnizimi Im dhe që kur është në vështirësi më thërret dhe Unë i ndihmoj, ndërsa, kur t'i kalojë vështirësia, i kthehet të këqijave të mëpasshme. A është duke treguar mosbindje ndaj Meje? Apo, është duke shkuar drejt ndëshkimit Tim? Betohem në Vetën Time se do të kërkoj një llogari të tillë prej tij, sa që nuk do të mund të gjejë asnjë rrugë shpëtimi dhe asnjë strehim. Ku mund të iki prej qiellit dhe prej tokës Time?

O Isa, thuaju mizorëve të Beni Israilëve që mos të më thirrin, përderisa duart e tyre mbajnë haram dhe në shtëpitë e tyre mbajnë idhuj. Unë jam betuar se do ta pranoj lutjen e lutësit. Përderisa janë të bashkuar, lutjet e tyre do t'i pranoj dhe nuk do t'i mallkoj.

O Isa, nuk ka të mbarë jeta e kalueshme dhe lezeti që nuk është i vazhdueshëm.

O biri i Merjemes, sikur të kishe parë se çfarë kam përgatitur për robtë e sinqertë, zemra do të të ishte shkrirë prej ankthit dhe shpirti do të të ndahej prej trupit, sepse, nuk ka saraj si saraji i Ahiretit. Aty do të jenë së bashku të pastrit; melekët do t'u afrohen dhe ata do të jenë të sigurt prej tmerit të Ditës së Kiametit. Saraji është i tillë që dhuntia nuk do të ndërrohet dhe nuk do të humbasë.

O biri i Merjemes, garo me garuesit që garojnë për dhuntitë e Ahiretit. Dhuntitë e Ahiretit janë vende të dëshirueshme dhe të bukura. Lum për ty, o biri i Merjemes, nëse je ndër ata që punojnë vepra të mira. Me veprat e tua do të jesh bashkë me baballarët e tu, Ademin dhe Ibrahimin, në Xhennetin prej të cilit nuk do të dëshirosh të ndahesh. Kështu i shpërblej ata që ruhen.

O Isa, ti ikën bashkë me ata që ikin prej zjarrit flakërues dhe prej dënimit me goditje të zinxhirëve. Në brendësi të këtij zjarri nuk do të hyjë asnjëherë mëshira dhe nuk do të largohet pikëllimi prej tij; është sikur pjesët e natës së errët; ai që shpëton prej tij, do ta arrijë sigurinë. Ai është vendi i tiranëve e mizorëve që i kanë kaluar kufijtë dhe të atyre që i kanë zemrat e vrazhda.

O Isa, kjo botë është një shtëpi e keqe për ata që i drejtohen asaj; shtëpia e mizorëve është një vend shumë i keq. Unë të mbroj ty prej vetvetes, prandaj, bëhu i vetëdijshëm për Mua.

O Isa, Më mbaj para syve kudo që të jesh dhe dëshmo për krijimin tënd. Ti je robi Im dhe Unë të kam krijuar të tillë dhe të kam zbritur në sipërfaqen e tokës.

O Isa, largoje veten prej epsheve shkatërruese. Ruaju nga të gjitha llojet e kënaqësive që të largojnë prej meje. Dije që ti je në shkallën e një peygamberi të besueshëm, prandaj, ruaju prej Meje.

O Isa, të krijova me fjalën Time dhe nëna jote, Merjemja, të lindi me urdhrin Tim. E dërgova melekun, Xhibrilin e besueshëm, bashkë me shpirtin Tim dhe ti u bërë ndër njerëzit që shëtisin në sipërfaqen e tokës. Të gjitha këto kanë kaluar në diturinë Time më herët.

O Isa, përderisa jam duke dënuar, nuk do të kesh dobi prej kënaqësisë së asnjërit.

O Isa, më përmend në vetmi dhe mes njerëzve, që Unë të të përmend në mesin e njerëzve të mbarë.

O Isa, më thirr Mua sikur ai që është duke u mbytur dhe që nuk ka kush ta shpëtojë.

O Isa, mos u beto pa sinqeritet ndaj Meje, sepse, nëse e bën këtë, froni Im dridhet prej zemërimit. Kohëzgjatja e kësaj bote është e shkurtër, por dëshira e saj është e gjatë.



Këshillat e Hazreti ISAIT (paqja qoftë mbi të!)

Lum për ata që janë të mëshirshëm; këta janë ata që do ta arrijnë mëshirën e All'llahut në ditën e Kiametit.

Lum për ata që i përmirësojnë marrëdhëniet ndërmjet njerëzve; në Ditën e Kiametit, ata do të jenë afër All'llahut. Lum për ata që i kanë zemrat e pastra, në Ditën e Kiametit, ata do të arrijnë dhuntinë e All'llahut.

Lum për njerëzit zemërbutë, në Ditën e Kiametit, do të ulen në fronet e sundimtarëve.

Lum për të varfërit; për ata është mbretëria e qiejve.

Lum për të pikëlluarit; ata janë njerëzit e dashur.

Lum për ata që kanë vuajtur prej urisë dhe etjes për hir të All'llahut; ata janë që do të ngrihen dhe që do t'u shuhet etja.

Lum për ata që punojnë të mbarën dhe që u drejtohen me "të zgjedhurit e All'llahut".

Lum për ju në kohën kur jeni xhelozuar, ofenduar dhe ju kanë folur fjalë të ndryshme. Bëhuni të gëzuar në ato kohëra, sepse sevapi juaj është duke u shtuar në qiell.


O robtë e këqij, njerëzit i fajësoni duke u bazuar në supozime, por veten nuk e fajësoni as për gjërat e sigurt (ju keni dëshirë që të flasin dhe t'ju bëjnë me gisht për gjërat që nuk i keni).

O robtë e kësaj bote, për t'u treguar si asketë, ju e ruani kokën tuaj, i shkurtoni këmishët tuaja dhe i ulni kokat poshtë, por xhelozoni dhe lakminë nuk mund ta nxirrni

prej zemrave tuaja. O robtë e kësaj bote, ju i përngjani varrezave të lyera me allçi, që të mahnitin kur i shikon nga jashtë, ndërsa përbrenda gjenden eshtrat e mbushur plot me gjynahe.

O robtë e kësaj bote, ju i përngjani drurit të rrëshirës që e djeg veten dhe u bën dritë tjerëve. O Bijtë e Israelit, edhe sikur të kishit qenë të detyruar për të shkuar zvarrë, mbushni kuvendet e dijetarëve. Sikur All'llahu që e ngjall tokën e tharë përmes rrebeshit të shiut, ashtu edhe i ngjall zemrat e vdekura përmes dritës së urtësisë. O Bijtë e Israelit, të folurit e paktë është një urtësi e madhe, prandaj, heshtni. Heshtja është një rehati e bukur dhe shkaktare e lehtësimi të gjynaheve dhe e pakësimit të gabimeve. Përforcojeni derën e diturisë; dera e diturisë është durimi. All'llahu i urren ata që qeshin së koti dhe që ecin në drejtim të një gjëje ku nuk ka dobi për edukatën dhe moralin, ndërsa, e do bariun që nuk është i pavëmendshëm për kopenë e tij dhe udhëheqësin që nuk është i pavëmendshëm për popullin e tij. Sikur që turpëroheni haptas prej njerëzve, ashtu edhe turpërohuni fshehtas prej All'llahut. Dijeni që fjala e urtë është malli i humbur i besimtarit. Prandaj, studiojini fjalët e urta, para se të dalin nga dora. Fjalët e urta do të dalin nga dora edhe me vdekjen e rrëfyesve (transmetuesve) të fjalëve të urta.

O zotëruesi i diturisë, nderoju dijetarët për hir të diturisë së tyre dhe mos polemizo me



ta. Të paditurit konsideroju të përbuzur, për shkak të paditurisë së tyre, por mos i përzë ata; afroju te ti dhe mësojua gjërat që nuk i dinë.

O zotëruesi i diturisë, dije që për çdo dhunti ndaj të cilit nuk u ke shprehur falënderimin, e ka shkallën e gjynahit prej të cilit do ta ndiesh ndëshkimin e tij.

O zotëruesi i diturisë, çdo gjynah që nuk shoqërohet me pendim është si dënimi me të cilin do të ndëshkohesh. O zotëruesi i diturisë, përgatitu për pikëllimet dhe brengat që sulmojnë papritmas.

Mos e shikoni të ndaluarën. Shikimi i tillë shpërndan farën e epshit në zemra dhe kjo mjafton si një nxitje për të mashtuar shikuesin. Lum për atë që vështrimi i tij merr pjesë në zemrën e tij dhe zemra e tij nuk merr pjesë në vështrimin e tij. Turpet e njerëzve shikojini si skllevërit, jo si pronarët. Janë dy lloj njerëzish: që i arrijnë fatkeqësitë dhe që e arrijnë lehtësimin. O Bijtë e Israelit, a nuk keni turp prej All'Ilahut? Ujin nuk mund ta pini pa e pastruar edhe prej papastërtive më të vogla, ndërsa, nuk ruheni prej mallit

që përmban haramin sa madhësia e elefantit. A nuk i keni dëgjuar këto fjalë prej Teuratit: "Përmbajuni marrëdhënieve familjare dhe gjenduni në mirësi ndaj tyre". Unë them kështu: Vizitoni ata që i kanë ndërperë marrëdhëniet me ju, dhurojini atij që kursen, bëjini mirë atij që bën keq, përshëndeteni atë që fyen, silluni drejt me personin që ju kundërshton, faleni atë që bën padrejtësi, sepse edhe ju keni dëshirë t'ju falen të këqijat. Merrni mësim prej faljes së All'Ilahut ndaj jush. A nuk po vëreni se dielli po i ngroh edhe të mirët, edhe të këqijtë dhe se shiu po bie mbi robtë e singertë e të padrejtë? Çka mund të jetë epërsia juaj ndaj të tjerëve

nëse i doni vetëm ata që ju duan, u bëni mirësi vetëm atyre që ju bëjnë mirësi dhe u dhuroni vetëm atyre që ju dhurojnë? Këtë e bëjnë edhe ata që i kanë mendjet e shthurura dhe që nuk janë të virtytshëm. Por, nëse dëshironi që të bëheni miku dhe robi i zgjedhur i All'Ilahut, bëjini mirë atij që ju bën keq, hiqni dorë prej fajit të të padrejtë dhe përshëndeteni atë që jua kthen fytyrën. Dëgjojeni fjalën Time, ruajeni amanetin Tim dhe respektojini këshillat e Mia, që të mund të bëheni të dijshtëm dhe njohës të fesë. Flas të vërtetën kur them se zemrat tuaja drejtohen kah vendi i thesarëve; për këtë arsye, njerëzit e duan mallin dhe epshet tuaja e mëtojnë atë. Prandaj, grumbulloni thesaret tuaja në qiell, aty ku është vendi i sigurt dhe ku nuk mund të arrijnë vjedhësit. Flas të vërtetën kur them se një rob nuk mund t'u shërbejë dy zotëruesve, patjetër duhet të bëjë zgjedhjen e njërit ndaj tjetrit. Ashtu edhe ju nuk mund të zotëroni njëkohësisht dashurinë e All'Ilahut dhe atë ndaj kësaj bote.

Flas të vërtetën kur them se më i keqi prej njerëzve është dijetari që preferon këtë botë ndaj diturisë; që e do këtë botë, që mëton për të dhe përpiqet për ta arritur. Sikur të kishte mundur t'i hutojë njerëzit ky dijetar, sigurisht se do të kishte bërë edhe këtë. Çfarë dobie ka drita ndriçuese e diellit për syrin e verbër? Dhe ngjashëm çfarë dobie ka dituria e këtij dijetari, kur nuk mund të veprosh sipas saj? Frytet e pemës janë të shumta, por nuk janë të gjitha të dobishme dhe nuk hahen. Edhe dijetarët janë të shumtë, por nuk mund të ketë dobi prej çdonjërit. Sa e gjerë është sipërfaqja e tokës, por nuk është e rehatshme çdo pjesë e saj. Edhe ata që flasin janë të shumtë, por nuk mund të dëshmohet fjala e çdonjërit prej tyre. Atëherë, ruaju prej dijetarëve që veshin rroba të leshta, që i fshehin gabimet e tyre duke ulur kokën poshtë, që veprojnë nën vetulla sikur ujku dhe që fjalët e tyre bien ndesh me veprat e tyre. A është e mundur vjelja e rrushit prej topalakut (një lloj druri) dhe vjelja e fikut prej degës së bostanit të Ebuxhehlit (babait të të padijshmëve)? Ngjashëm, edhe fjala e dijetarit gënjeshtar nuk mund të prodhojë tjetër veçse të pavërtetën dhe gënjeshtren. Nuk e flet të vërtetën që e flet çdonjëri.

Flas të vërtetën kur them se fara mbin mbi tokën e butë dhe të rrafshët, jo mbi shkëmb. Ngjashëm, edhe urtësia vendoset në zemrën modeste, jo në zemrën e njeriut të vrazhdë dhe kryelartë. A nuk e di se kush e mban kokën lart, tavani ia godet kokën dhe kush e mban kokën ulur, do të ketë dobi prej hijes së tij. Kështu që, kush nuk tregon modesti për All'Ilahun, All'Ilahu do ta poshtërojë atë, dhe kur e bën këtë, All'Ilahu do ta lartësojë atë. Sikur që mjalti prishet



nëse shishja nuk është e përshtatshme, ashtu edhe urtësia nuk mund të qëndrojë në zemrën e çdonjërit. Nëse shishja nuk është e shpuar dhe e pastër, mjalti do të mund të qëndrojë për një kohë më të gjatë. Ngjashëm, përderisa zemrën nuk e shpon epshi, nuk e përlyen lakmia dhe nuk e bën të vrazhdë dhuntia, urtësia do të mund të qëndrojë aty.

Flas të vërtetën kur them se, nëse digjet një shtëpi dhe nëse zjarri vazhdon të kalojë në shtëpitë e tjera, shumë shtëpi do të bëhen hi. Por, nëse arrihet të shuhet zjarri te shtëpia e parë, atëherë nuk do të digjen shtëpitë e tjera. Edhe mizori i parë është i tillë; nëse mund të parandalohet mizoria e tij nga ana e njerëzve, atëherë nuk mund t'i bashkohet mizori i dytë. Nëse zjarri nuk mund të gjejë dru dhe dërrasa në shtëpinë e dytë, atëherë nuk mund të djegë asgjë.

Flas të vërtetën kur them se njëri e vëreu gjarprin duke u afruar te vëllai i tij dhe ai nuk i tregoi atij, dhe nëse vëllai i tij do të kafshohej dhe mbytej, atëherë ky do të bëhej ortak në mbytjen e tij.


Kush ka fuqi për të parandaluar një mizor nga mizoria e tij dhe ai këtë nuk e bën, atëherë do të konsiderohet si ai që e ka bërë atë gjynah.

Lajmi i vdekjes së tre shokëve

Një ditë Isai, i biri i Merjemes së bashku me tre shokë të tij dolën për të përmbushur nevojat e tyre. Gjatë rrugës ata kaluan pranë një qypi me flori. Isai (paqja qoftë mbi të!) u tha shokëve të tij: "Ky vret njerëz." Pastaj, u largua.

Njëri nga shokët tha: "Unë kam për të kryer një nevojë dhe u largua."

Si i dyti, ashtu edhe i treti të njëjtën gjë thanë dhe u larguan nga hazreti Isai. Të tre së bashku u takuan te vendi ku ndodhej floriri. Dy nga shokët i thanë të tretit: "Shko dhe na bli ushqim." Shoku i tyre shkoi për të blerë ushqim dhe në të vendosi helm për t'i helmuar dy shokët e vet që ata të mos merrnin pjesë nga floriri.



Kur u largua i treti, njëri nga ata të dy i tha tjetrit: "Kur të sjellë ushqimin, ta vrasim që të mos marrë pjesë nga floriri." Sapo mbërriti me ushqimin, ata e vranë, e hëngrën ushqimin e helmuar dhe vdiqën të dy. Hazreti Isai u kthye tek ata dhe i gjeti të vdekur. Pastaj me urdhrin e All'Ilahut Fuqiplotë i ringjalli dhe u tha atyre: "A nuk ju thashë që ky (floriri) vret njerëz?!"


Këtu duhet të dimë se ata tre shokët nuk kanë qenë prej dëgjuesve të hazreti Isait, të cilët arritën në shkallën e lartë të besimit.

Të dashur fëmijë!

Dijeni se krijimi dhe lindja e hazreti Isait (paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!) ka qenë një nga mrekullitë e All'Ilahut të Madhëruar. Ai dërgoi te hazreti Merjemja (nëna e Isait) një melek në formën e njeriut. Kur e pa, Merjemja u frikësua prej tij. Meleku i tha: "Mos u frikëso! Unë jam dërguar nga All'Ilahu që të të përgëzoj me lindjen e një djali me emrin Isa, të cilin do ta lindësh ti. Ai do t'u flasë njerëzve që në djep dhe do të jetë profet për bijtë e Izraelit."

Në atë kohë, Merjemja ishte e virgjër dhe e pamartuar. Kur dëgjoi fjalët e melekut, ajo u habit dhe tha: "Si do të lind unë fëmijë kur nuk kam bashkëshort?!" Meleku i tha: "Vërtet, All'Ilahu krijon çfarë të dojë dhe kur do diçka i thotë "Bëhu!" dhe ajo bëhet."

Pas një kohe të shkurtër, Isai filloi të formohej në barkun e nënës së tij. Atë e krijoi All'Ilahu pa baba, njësoj si krijoi Ademin nga balta, pa baba e pa nënë. Këtë gjë na e sqaron edhe Kur'ani fisnik kur thotë: "Rasti i Isait për All'Ilahun është si rasti i Ademit që e krijoi prej baltës e pastaj i tha: "Bëhu!" dhe ai u bë." (Sure "Ali Imran", ajeti 59)



Profetësia e hazreti Isait

Kur hazreti Isai u rrit, All'Ilahu e dërgoi profet për Bijtë e Izraelit dhe i zbriti Inxhilin (Biblën). Në Inxhil gjendeshin mësimet dhe udhëzime fetare për t'u mësuar bijve të Izraelit besimin në All'Ilahun, adhurimin e Tij, njohjen e moraleve të pëlqyera dhe ndalimin nga të këqijat. Ata e përgënjeshtroan hazreti Isain dhe i kërkuan atij disa mrekulli që të bindeshin se ai ishte profet i All'Ilahut.

Prej mrekullive të hazreti Isait kanë qenë:
Shërimi i sëmundjeve të rënda me urdhrin e All'Ilahut.
Ringjallja e të vdekurve me lejen e All'Ilahut.

Merjemja e lindi fëmijën e saj, hazreti Isain në Betlehem në Palestinë. Pas lindjes, së bashku me fëmijën e porsalindur, shkoi te populli i saj. Kur e panë, ata u zemëruan prej saj dhe filluan ta ofendonin. Mirëpo, All'Ilahu i Madhëruar e bëri hazreti Isain të flasë dhe u tha atyre: "Unë jam rob i All'Ilahut dhe Ai më ka zgjedhur mua që të jem profeti juaj. Ai më ka porositur që ta respektoj nënën time dhe më ka urdhëruar të fal namazin e të jap zekatin për aq kohë sa të jem gjallë."

Një ditë, besimtarët i kërkuan hazreti Isait që t'i lutej All'Ilahut t'u zbriste atyre një sofër nga qielli. Hazreti Isai iu lut All'Ilahut dhe Ai ia zbriti sofrën nga qielli në të cilën gjendeshin llojet e ushqimeve që i kërkuan.

Me gjithë këto mrekulli që hazreti Isai kishte, prap se prap bijtë e Izraelit nuk e besuan, me përjashtim të një pakice njerëzish.

Hazreti Isai i ka lajmëruar bijtë e Izraelit për ardhjen Profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!). Këtë e vërteton edhe Kur'ani fisnik, i cili në suren "Saff", në ajetin 6 thotë: "Kujto kur Isai, i biri i Merjemes, tha: "O bijtë e Izraelit, unë jam i dërguari i All'Ilahut tek ju, për t'ju vërtetuar Teuratin e shpallur para meje dhe për t'ju sjellë lajmin e gëzueshëm

për një të dërguar, emri i të cilit është Ahmed, që do të vijë pas meje". Por, kur ai u solli atyre shenja të qarta, ata thanë: "Kjo është magji e hapur!"

Përpjekja e bijve të Izraelit për ta vrarë hazreti Isain

Bijtë e Izraelit (jehuditë) e përgënjeshtroan dhe silleshin shumë keq ndaj hazreti Isait. Ata e akuzonin nënën e tij se ka bërë një vepër të shëmtuar dhe nuk i besuan atij, edhe pse hazreti Isai i këshillonte vazhdimisht.

Në fund, ata u përpoqën që ta vrisnin hazreti Isain, ashtu siç vranë edhe profetë të tjerë më parë, por All'Ilahu i Madhëruar e shpëtoi atë. Ata as që e vranë e as që e kryqëzuan, sepse All'Ilahu e ngriti në qiell dhe është i gjallë. Për këtë gjë, Kur'ani fisnik në suren "Nisa", ajetet 157-158, thotë: "Dhe për fjalët e tyre: "Ne e vramë Mesihun – Isain, të birin e Merjemes, të Dërguarin e All'Ilahut". Por, ata as e vranë, as e kryqëzuan, por ashtu u është dukur. Ata që nuk u pajtuan për çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të. Ata nuk kanë ditur kurrgjë për të, por vetëm kanë hamendësuar. Ata, në të vërtetë, nuk e kanë vrarë, por, All'Ilahu e ka ngritur pranë Vetes. All'Ilahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëditur."

